



RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS PËR KOMPANITË E UJËSJELLËSIT DHE MBETURINAVE NË KOSOVË NË 2011

Raporti për performancën e kompanive të licensuara të furnizimit me ujë, shërbimeve të ujërave të zeza, furnizimit me shumicë të ujit të patrajtuar dhe kompanive të mbeturinave të ngurta

Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Mbeturina

Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efikente të ujësjellësit, ujërave të zeza dhe mbeturinave për të gjithë konsumatorët në tërë Kosovën.”

Misioni

“Rregullimi i shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave të ngurta në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikat e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujësjellësit dhe të mbeturinave japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit Publik.”

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCES SË KOMPANIVE TË UJIT DHE TË MBETURINAVE NË KOSOVË PËR VITIN 2011

PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse	v
Roli dhe përgjegjësitë e ZRRUM	vii

A FURNIZIMI ME UJË DHE SHËRBIMET PËR UJËRAT E ZEZA

1	Hyrje	10
2	Zhvillimet në sektor	11
3	Performanca e KRU	13
3.1	Furnizimi me ujë	13
3.2	Shërbimet për ujëra të zeza	26
3.3	Performanca financiare e KRU	32
3.4	Performanca e përgjithshme e KRU	35
4	Performanca e sektorit	39
4.1	Uji i prodhuar, shitjet dhe UPF	39
4.2	Mbulueshmëria me shërbime	40
4.3	Të ardhurat e planifikuara, qarkullimi dhe paraja e gatshme e arkëtuar	40
4.4	Shpenzimet kapitale (mirëmbajtja dhe rritja kapitale)	41
5	Performanca e furnizuesit të ujit me shumicë (NH Iber-lepenci)	43
6	Aktivitetet e KKK	44
7	Sfidat për të ardhmën	45
SHTOJCA 1	Të dhënat e detajuara të performancës	47
SHTOJCA 2	Definicionet dhe arsyeshmëria	62
SHTOJCA 3	Pasqyrat përmbledhëse të të ardhurave	69
SHTOJCA 5	Pasqyrat tarifore(2012-2014)	72
SHTOJCA 5	Detajet kontaktuese	73
SHTOJCA 6	Zonat e shërbimit të KRU	75

B SEKTORI I MBETURINAVE

1	Zhvillimet në sektorin e mbeturinave	77
2	Performanca e përgjithshme e sektorit të mbeturinave	78
2.1	Metodologjia e vlerësimit të performancës	80
2.2	Performanca e përgjithshme e KRM	80
3	Performanca krahasuese e kompanive të grumbullimit të mbeturinave	82
3.1	Performanca teknike	82
3.2	Performanca e nivelit të shërbimit	84
3.3	Performanca financiare	85
4	Performanca e Kompanisë për menaxhimin e Deponive në Kosovë	89
5	Sfidat për të ardhmën	90
SHTOJCA 1	Të dhënat e detajuara të performancës	91
SHTOJCA 2	Informatat mbështetëse	96
SHTOJCA 3	Tarifat për grumbullimin e mbeturinave (2012-2013)	98
SHTOJCA 4	Detajet kontaktuese	99
SHTOJCA 5	Zonat e shërbimit të KRM	100

Akronimet dhe shkurtesat

BE	Bashkimi Evropian
BD	Bordi i Drejtorëve
ESK	Enti i Statistikave të Kosovës
FE	Kompania Rajonale e Ujit Bifurkacioni (Ferizaj)
GJA	Kompania Rajonale e Ujit Radoniqi (Gjakova)
GJI	Kompania Rajonale e Ujit Hidromorava (Gjilan)
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
IL	NH Ibër Lepenci
NJPM-NP	Njësia për Politika e Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
KKK	Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
KRM	Kompania Rajonale e Mbeturinae
KRU	Kompania Rajonale e Ujit
MIT	Kompania Rajonale e Ujit Mitrovica (Mitrovicë)
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
NP	Ndërmarrje Publike
PE	Kompania Rajonale e Ujit Hidrodrini (Pejë)
PR	Kompania Rajonale e Ujit Prishtina (Prishtinë)
PZ	Kompania Rajonale e Ujit Hidroregjioni Jugor (Prizren)
TFU	Taskë Forca e Ujit
UPF	Uji i pa-faturuar
ZNKE	Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian
ZRRUM	Zyra Rregullatore për Ujësjellës dhe Mbeturina

Fjala hyrëse



Ky është viti i gjashtë i vlerësimit të performancës për kompanitë e furnizimit me ujë, shërbimeve të ujërave të zeza, shitjes së ujit me shumicë dhe mbeturinave të ngurta në Kosovë për vitin 2011. Publikimi i Raporteve të Performances vazhdon të përmbushë një prej synimeve të ZRRUM ndaj shpërndarjes së informacioneve të sakta dhe të besueshme për të gjitha palët e interesuara në lidhje me shërbimin e furnizimit me ujë, çështjeve sanitare si dhe të mbeturinave. Vlerësimi Krahases-Benchmarking dhe publikimi i performancës së ofruesve të shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave në kushtet e monopolit të plotë është një mekanizëm i rëndësishëm për të ngritur transparencën dhe konkurrencën e shëndetshme në mes tyre, me synim për të stimuluar përmirësimin e treguesve të punës.

Në përgjithësi niveli i shërbimit të furnizimit me ujë në 2011, në raport me performancën ideale është në nivelin 76% dhe është me e përmirësuar për 3% në krahasim me vitin 2010. Përderisa, në nivel të sektorit performanca e përgjithshme e shërbimeve të ujërave të zeza për 2011 është 34%, në krahasim me performancën e kompanis ideale të synuar, duke mos shënuar ndonjë ndryshim nga viti 2010. Kjo gjendje me nivelin e shërbimit të ujërave të zeza, lenë të kuptohet se ky sektor në të ardhëmen ka nevojë të mëdha për investime po thuajse në të gjitha fushat, që nga zhvillimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza dhe objekteve përcjellëse e deri te zgjerimi i rrjeteve të kanalizimit.

Performanca mesatare e sektorit në vitin 2011, për të dy shërbimet (Furnizim me ujë dhe Shërbime të ujërave të zeza), ka arritur shumë pak progres megjithatë ende është nën nivelin e 50%, të performancës ideale. Arsyeja kryesore për gjendejen aktuale të performancës së përgjithshme nuk është vetëm performanca e shërbimeve të ujërave të zeza, (mbulueshmëria e ultë me shërbime si dhe mungesa e trajtimit të ujërave të zeza), por edhe performanca ende e ultë e efijences komerciale në përgjithësi tek të gjitha kompanitë.

Niveli jo kenaqshëm i pothuajse i të gjithë treguesve të punës së ofruesve të shërbimeve që i kemi të regjistruar në këtë raport për të dy sektorët në përgjithësi, nënkupton nevojën që të gjitha palët e interesit të luajnë rolin e tyre në drejtim të përmirësimit të tyre si dhe ofrimit e shërbimit të përmirësuar, në radhë të parë ketu mendohet për ofruesit e shërbimit meqenëse ata janë përgjegjesit kryesor për tu përballur me disa prej treguesve me sfidues:

S'pari, ngritja e e efijencës në shkallën e arkëtimit të faturave për shërbimet e ofruara, në vitin 2011 ka shënuar një përmirësim prej 3%, megjithatë niveli aktual i ultë prej 69% për sektorin e ujit dhe 61% për sektorin e mbeturinave shprehë domosdoshmërinë që institucionet, bizneset dhe konsumatorët e amvisëris, duhet sensibilizuar për të bërë pagesat në kohë të faturave të tyre. Kjo pra, do të jetë mënyra e vetme dhe e sigurtë për qëndrueshmerin financiare të ofruesve të shërbimeve dhe ngritjes së sigurt të nivelt të shërbimit.

S'dyti, orientimi komercial i menaxhimit të biznesit në Kompanit Rajonale të Ujit (KRU), vazhdon të jetë e ulët, kjo tregohet sidomos me shkallën e lartë (61%), të ujit të pa-faturuar (UPF). Humbjet e ujit fitojnë dimensionin e plotë nëse ato shprehen në vlera numerike, nga 146 mil, m³ të ujit të prodhuar, rreth 90 milion m³ në vitin 2011, ka qenë ujë i humbur apo ujë i cili nuk ka sjellur të ardhura për kompanitë, për më tepër janë krijuar shpenzime për prodhimin e tij, kjo është për keqardhje kur dihet se kërkesa për ujë megjithatë dita ditës vazhdon të rritet.

S'treti, synim strategjik i ofruesve të shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave, duhet të jetë mbulueshmëria e plotë e popullates me shërbime të ujësjellësit dhe ujërave të zeza, ende 1/4 e popullësisë nuk është e kyqur në sistemin qëndror të ujësjellësit përderisa vetëm gjysma e tyre marrin shërbime të kanalizimit dhe shërbime të grumbullimit të mbeturinave. Shërbimet e

trajtimit të ujrave të zeza janë në fazën fillestare me vetëm një fabrikë të trajtimit të ujërave të zeza.

Një sfidë më tej është që të tejkalohen pritjet e konsumatorëve të cilët në shumë raste janë ankuar për ofrimin e dobët të shërbimit, ankesat e tyre kryesisht lidhen me mënyrën e faturimit në mungesë të ujëmatësit, ndërprerjet e shpeshta dhe reduktimet e ashpra të ujit e deri tek dështimet e kualitetit të ujit. Ofruesit e shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave duhet vazhdimisht të rrisin perkushtimin për të krijuar marrëdhënie reciproke në mes të cilësisë së shërbimit dhe çmimit të cilin e paguajnë konsumatorët, kjo duhet të bëhet me qëllim për të reduktuar ngarkesat që konsumatorët duhet të paguajnë për mosefikasitetin e ofruesve të tyre shërbimeve, megjithatë me përmirësimin e cilësisë së shërbimit shumica e konsumatorëve janë të gatshëm të paguajnë për një vlerë të shërbimit.

Në planin strategjik për vitin 2012-2014, ne kemi vendosur synime strategjike të cilat kanë për qëllim ngritjen nivelit të shërbimit ndaj konsumatorëve të shërbyer nga KRU. Fillimisht kërkohet nga KRU të përmirësojnë, vazhdueshmërinë e furnizimit, ngritjen e kualitetit të ujit, përmirësimin e saktësisë së faturimit përmes vendosjes së ujëmatësve, mirë të mirëmbajtur dhe të kalibruar si dhe azhurnimin në shqyrtimin dhe zgjedhjen e ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve, të cilat janë identifikuar si sfida me të rëndësishme aktuale.

Spektori i mbeturinave vazhdon të ketë performancë të dobët edhe në vitin 2011, përmirësim nuk është shënuar në mbledhjen e të ardhurave nga faturimi për shërbimin e ofruar, shpenzimet operative për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave në vazhdimësi janë duke u rritur.

ZRRUM-i pas 15 Korrikut 2012, nuk do të rregullojë më aktivitetet e ofruesve të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave në pajtim me Ligjin e Mbeturina Nr. 04/L-060). Me ligjin e ri janë paraparë që të gjitha përgjegjësit institucionale të ZRRUM-it, në lidhje me licencimin, përcaktimin e tarifave, përcaktimin dhe mbikqyrjen e standardeve të shërbimit, etj. të barten të Qeveria e Kosovës dhe Pushteti Lokal. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, sektori i grumbullimit të mbeturinave të ngurta komunale plotësisht do të de-rregullohet dhe do të nënështrohet konkurrencës së tregut.

Fokusi i punës sonë gjatë vitit 2011, ishte në shqyrtimin dhe përcaktimin e tarifave, për kompanitë ujit për periudhën e ardhshme tri vjeçare 2012-2014, dhe tarifave për shërbimet e mbeturinave në përputhje me metodologjitë e caktuara veq për shërbimin e ujit dhe veq për shërbimin e mbeturinave. Tek të dy shërbimet kemi aprovuar ngritje të tarifave, duke qenë të kujdesshëm në balancimin e interesave të konsumatorëve për shërbime të mira me nevojën për të ruajtur integritetin financiar të Kompanive.

Është e rëndësishme që ofruesit e shërbimeve të pranojnë se planet e Bizneseve të cilat ne i kemi përdorur si bazë për përcaktimin e tarifave janë "obligime kontraktuese" e nënkuptuar në këmbimin më tarifat e aprovuara. Ne kemi bërë përpjekje për t'u siguruar konsumatorët të marrin shpjegimin e mirë, se pse faturat e tyre do të kenë rritje, dhe kemi arsyetuar kostot e kompanive, përfshirë shpenzimet operative si dhe nevojat e domosdoshme për investimet kapitale me qëllimin e vetëm për të ruajtur dhe ngritur nivelin e shërbimit, ne do të jemi këmbëngulës në vendosmerin tonë për të siguruar se ofruesit e shërbimeve i përmbushin detyrimet e tyre të kontraktuara dhe në mënyrë rigoroze do të monitorojm performancën kundrejt detyrimeve të tyre.

Ne po ashtu kemi amandamentuar dy rregulla të cilat në fokus kanë përmirësimin e shërbimit ndaj Konsumatorëve, Rregulla për Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve si dhe Rregullën për Standardet Minimale të Shërbimit. Standardet Minimale të Shërbimit janë obligim ligjor të cilat janë parapara të plotësohen nga KRU, duke përfshirë aspektet tekniko-operative si dhe komerciale, shumica e këtyre standardeve kanë edhe afatet ligjore të cilat duhet përmbushur nga KRU. Roli dhe përgjegjësit e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve, janë definuar edhe

me qartë si dhe jemi në vazhden e angazhimve për ngritjen e profilit të tyre, përmes trajnimeve, përpilimit të procedurave të punës së tyre, si dhe janë realizuar vizita studimore jashtë vendit me qëllim të marrjes së praktikave më të mira.

Së fundi, unë falënderoj Komisionin European për mbështetjen e ZRRUM, përmes projektit dy vjeçarë në mbështetje institucionale për ZRRUM, i cili ka përfunduar në Maj të këtij viti. Po ashtu shprehur respektin e plotë për implementuesin e këtij projekti, konsorciumin e udhëhequr nga IPA për implementimin e suksesshëm të këtij projekti.

Po ashtu unë dëshiroj të falënderoj edhe stafin e ZRRUM për përpilimin e këtij raportit dhe për angazhimin e tyre në punën e përditëshme të tyre .

Raif Preteni
Drejtore i ZRRUM



ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E ZRRUM

Zyra Rregullatore për Ujesjelles dhe Mbeturina(ZRRUM), është rregullator ekonomik i shërbimeve të furnizimit me ujë, ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta në Kosovë. Është themeluar në vitin 2004, përmes Rregullorës së UNMIK 2004/49 e cila më pas është zëvendësuar me Ligjin Nr. 03/L-086 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në Qershor 2008. si institucion i pavarur me përgjegjesin për rregullimin e veprimtaris së ofruesve të shërbimeve të ujësjellesit, kanalizimit, dhe mbeturinave në Kosovë, është llogaridhëns për punën e tij para Kuvendit të Kosovës.

Pra, roli i ZRRUM është të zbatoj një kornizë efektive rregullatore që inkurajon ofruesit publik të shërbimeve të ujë dhe të mbeturinave, për të siguruar një shërbim me cilësi të lartë dhe me vlerë për paratë që i marrin nga konsumatorët, dhe duke bërë rregullimin shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave në mënyre transparente në pajtim me praktikën e mira rregullatore, duke pasur kujdes gjithënjë në ruajtjen e mjedisit dhe të mbrojtjes së shëndetit të popullatës.

Në mënyrë specifike përgjegjesit e ZRRUM, janë:

- Dhënja e licencave për ofruesit e shërbimeve të ujësjellesit dhe kanalizimit si dhe mbeturinave të ngurta komunale.
- Përcaktimi i çmimeve për shërbimet e ofruara me koston sa më të arsyeshme, duke i balancuar interesat e konsumatorëve për shërbime të mira me nevojën për të ruajtur integritetin financiar të ofruesve të shërbimeve.
- Stimulimi i konkurrencës në sektorët e ujit dhe mbeturinave përmes krahasimit të performancës (benchmarking) si dhe raportimit të rregullt të performancës duke u fokusuar në shërbimet ndaj konsumatorëve, shpenzimeve, investimeve si dhe objektivave të planifikuara.
- Mbrojtja e interesave të konsumatorëve duke siguruar që shërbimet e ofruara janë në përputhje me standardet e vendosura.
- Sigurimi se konsumatorët kanë në disponim mekanizma të përshtatshëm për të parashtruar ankesat e tyre ndaj ofruesve të shërbimeve.
- Promovimi i interesave të konsumatorëve të shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave, duke ndihmuar dhe siguruar që ata të marrin një shërbim me cilësi të lartë.
- Sigurimi se konsumatorët janë të informuar për të drejtat dhe obligimet e ndërsjellta respektive, Ofrues i shërbimit-konsumator.

Në pajtim me praktikën e mirë rregullatore, qasja e ZRRUM, është e orientuar drejt rezultateve konkrete, duke mos ndërhyrë drejtëpërdrejtë në menaxhimin ditor të ofruesve të licensuar të shërbimeve, dhe duke e lënë këtë përgjegjësi për menaxhmentet si dhe bordet e ofruesve të shërbimit. Për më tepër, ZRRUM nuk ka asnjë juridiksion mbi furnizimet private me ujë, dhe mbi disa prej operatorëve joformal privat për grumbullimin e mbeturinave.

ZRRUM, nuk është përgjegjës po ashtu për rregullimin e cilësisë së ujit të pijshëm dhe aspekteve mjedisore, megjithatë ai punon për së afërmi me IKSHP dhe MMPH, të cilat janë institucione përgjegjëse për këto fusha të rëndësishme.

A FURNIZIMI ME UJË DHE SHËRBIMET PËR UJËRAT E ZEZA

1 HYRJE

Raporti për performancën e kompanive të licencuar të furnizimit me ujë, shërbimeve të ujërave të zeza, furnizimit me shumicë të ujit të patrajtuar dhe kompanive të mbeturinave të ngurta është në vitin e gjashtë të botimit, ky paraqet një dokument të plotë dhe të detajuar për performancën e ofruesve të shërbimeve dhe të gjendjes së këtyre sektorëve në përgjithësi.

Raporti përfshin informacionin nga gjitha fushat kritike të performancës së ofruesve të shërbimeve siç janë; aspektet operative, financiare dhe të shërbimit ndaj klientit, nga shtatë kompanit rajonale të ujësjellësit dhe të kanalizimit, shtatë kompanit rajonale për grumbullim të mbeturinve, një ofruesit të furnizimit të ujit të pa trajtuar me shumicë si dhe një kompanie për menaxhimin e deponive në Kosovë.

Në këtë raport palët e interesit, e sidomos konsumatorët mund të shohin më për së afërmi performancën e ofruesve të tyre të shërbimeve në vitin 2011 në raport me vitin 2010, si dhe performancën e çdo ofruesi të shërbimeve në krahasim me ofruesit e tjerë të shërbimeve të njëjta në Kosovë, me rëndësi të veçantë është edhe krahasimi i performances aktuale të ofruesve të shërbimeve në raport me objektivat e dakorduara me rregullatorin gjatë procesit tarifar. Po ashtu, me rëndësi është se menaxheret e ofruesve të shërbimeve në bazë të informacioneve të dhëna në këtë raport mund të krahasojnë performancën e tyre me të tjeret dhe këto fakte menaxhmentit të ju shërbejnë si shtytës për ngritjen e efikasitetit.

Ky raport është i ndarë në dy (2) pjesë kryesore: Pjesa A- Furnizimi me ujë dhe shërbimet e ujërave të zeza, Pjesa B-Sektori i mbeturinave, si dhe Shtojcave të bashkangjitura.

Në pjesën A- filimisht në kapitullin e 3, pasqyrohet performanca e KRU përmes një numri të grafeve dhe të tabelave të shoqruara me analiza dhe komente përcjellëse për tregusit me kryesor të performancës për furnizimin me ujë dhe veçmas për shërbime të ujërave të zeza. Në kapitullin e 4 është e paraqitur pasqyra e performancës së sektorit në periudhën 2006-2011, ku janë analizuar aspekte të tilla si: uji i prodhuar, shitjet dhe uji i pa-faturuar (UPF), të hyrat dhe arkëtimi i të ardhurave si dhe shpenzimet kapitale.

Më tej vazhdohet, në kapitujt 5 dhe 6 me shqyrtimin dhe analizën e performancës të furnizuesit të vetëm me ujë të patrajtuar me shumicë, NH Iber-lepenci si dhe të Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve (KKK).

Në fund të çdo pjesë të raportit paraqesim mendimet tona në lidhje me sfidat e së ardhmës për këtë sektorë në Kosovë (kapitulli 7 Sfidat për të ardhmen), në veçanti nevojën për KRU për të marrë më seriozisht obligimet e tyre të investimeve të përcaktuara në biznes planet e tyre rregullatore.

Pjesa B- është e ngjajshme me pjesën A, vetëm se fokusohet në sektorin e mbeturinave, në vazhdim në kapitujt 3 dhe 4 është dhënë performanca dhe vlerësimi krahasues i Kompanive Rajonale të Mbeturinave (KRM) si dhe performanca e Kompanis për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK), në kapitulli 5 të kësaj pjese janë dhënë mendimet tona për sfidat për të ardhmen e sektorit të mbeturinave.

Në përfundim të çdo pjese kryesore të raportit në ofrojmë informacione shtesë, përmes një serie të shtojcave duke përfshirë: të dhëna të detajuara të performancës për secilën ofruesve të shërbimeve, informacione tjera mbështetëse siç janë definicionet e treguesve, kriteret e vlerësimit të performancës, pasqyrat financiare, pasqyrat tarifore dhe detajet e kontaktit.

Tabelat janë përpunuar në formën e tillë që palët e interesuara (lexuesi) mund lehtësisht të përdor informacionin për qëllime të tyre.

2 ZHVILLIMET NË SEKTOR

Struktura aktuale e sektorit të ujit në Kosovë

Praktikat e mira rregullatore mbështesin ndarjen e çartë të roleve të tre organeve kryesore të përfshira në sigurimin e ofrimit të shërbimeve të duhura për konsumatorët. Këto organe përbëhen nga Qeveria (që merret me përcaktimin e politikave dhe legjislacionit sektorial nëpërmjet prezantimit të ligjeve të nevojshme), rregullatori ekonomik dhe i kualitetit të shërbimit (që përcakton tarifat dhe mbron interesat e konsumatorëve), dhe ofruesit e shërbimeve (që ofrojnë shërbime të arsyeshme për konsumatorët).

Struktura aktuale e sektorit të ujit dhe të ujërave të zeza në Kosovë, përbërë nga shtatë kompani rajonale të furnizimit me ujë dhe shërbime të ujërave të zeza, të cilat janë të rajonalizuara në bazë të kufijve të ujëmbledhësve lumor dhe me ekonomi të konsiderueshme të shkallës, rregullohen nga Rregullatori i pavarur (ZRRUM) i themeluar sipas Ligjit Nr 03/L-086 dhe i cili është llogaridhënës ndaj Kuvendit të Kosovës, i cili plotësisht i përmbush këto kritere. Në fakt sektori i ujit në Kosovë është më i përparuar se sa në vendet e tjera në rajonin e Ballkanit në lidhje me efikasitetin, llogaridhënjën, dhe pajtueshmërinë me standardet Evropiane.

Trajtimi i Ujërave të zeza

Mënjanimi i duhur i ujërave të zeza është gjithashtu çështje vitale për shëndetin publik. Ajo është çështje brengosëse e cila sa shkon e rritet në Kosovë, ku mungesa e aranzhimeve për mënjanimin e tyre nënkupton që lumenjtë dhe burimet nëntokësore çdo herë e më shumë po rrezikohen nga kanalizimi. Është e evidente se Impiantet e trajtimit të ujërave të zeza janë projekte mjaft të shtrenjta, kështu Agjencionet Zhvillimore në Kosovë kanë ndermarr investime fillestare në ndërtimin dhe në iniciimin e projekteve për trajtimin e ujërave të zeza në rajone të ndryshme të Kosovës, impianti i parë¹ për mënjanim të ujërave të zeza është në Skenderaj i cili tani më është në funksion dhe i është dhënë në menaxhim KRU 'Mitrovica'. Po ashtu, vlenë të theksohet se në vitin 2011 e në vazhdim, është duke u punuar në zhvillimin e Master Planit Strategjik për Kanalizim & Ujëra të Zeza për Pellgun e Lumit Morava Perëndimore.

Roli i komunave në sektorin e Shërbimeve të ujit

Sektori i ujit në Kosovë është ballafaquar me një debat të gjerë të palëve të interesit për të përafuar qëndrimet e skajshme të nivelit qendror dhe të pushtetit lokal në menaxhimin e shërbimeve të sektorit të ujit. Në fakt ligji për vetëqeverisjen lokale i miratur në vitin 2008, në nenin 17.1 përveç tjerash për komunat parasheh kompetenca edhe në ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve komunale, përfshir furnizimin me ujë, kanalizim dhe trajtim të ujërave të zeza, duke lënë hapësirë për keq interpretime të shpeshta dhe duke rënë në kundërshtim me ligjin e NP. Në përgjithësi, palët e interesit u pajtuan me qëndrimet se pronaria e Qeverisë së Kosovës të ruhet dhe ajo të jetë pronare e 100%, të aksioneve në KRU, ashtu siç e parasheh edhe Ligji mbi Ndermarrjet Publike, si dhe të përforcohet roli i Komunave mbi KRU, përmes Bordeve të Drejtorëve, u dakordua po ashtu se këto aranzhime të bëhen gjatë amandamentimit të ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Ligjit për ndërmarrjet publike me Nr.04/L-111,

Në muajin Maj të vitit 2012, u dekretua nga Presidentja e Kosovës, ligji Nr.04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-087, të Ndërmarrjeve Publike, me këtë ligj janë parapar disa ndryshime të rëndësishme si në vijim; (i) mbikqyrje e vazhdueshme dhe rigorozë e aksionarit (NJPM-NP) mbi Bordet e Drejtorëve, (ii) kushtëzimin e kompenzimit të drejtorëve me performancën e tyre e cila do të tregohet me pasqyrat e audituara financiare dhe nga raporet e publikuar të performancës nga Zyrat Rregullatore, (iii) për komunat janë parapar disa aranzhime të cilat lidhen me të drejtën e Komunave

¹ Bashkimi Evropian ka financuar Impantin e trajtimit të ujërave të zeza në Skenderaj.

për të krijuar Ndërmarrje Publike Lokale , të drejten e përfaqësimit të tyre në BD, të kompanive të ujit ku ato ofrojnë shërbimet e tyre me të paktën gjysmën e numrit të drejtorëve si dhe të drejten për tu informuar për punën e Ndërmarrjeve Publike të cilat ofrojnë shërbimin në atë Komunë.

Integrimi i skemave rurale në kuader të KRU

Që nga pas lufta në Kosovë, janë të ndertuara një numër i madhë i skemave të veçanta të ujësjellësive rural, kryesisht me ndihmën e donatorëve të huaj, pushteteve lokale dhe të vetë komuniteteve. Ndërtimi i këtyre ujësjellësive në zonat rurale ka ndikuar drejtpërsëdrejti në rritjen e cilësisë së jetesës dhe higjienës së popullatës e cila jeton në ato zona, megjithatë është për tu brengosur se shumica e këtyre skemave nuk janë duke u menaxhuar në mënyrë më të mirë të mundshme, prandaj një pjesë e tyre, tani me janë jashtë funksionit. Diku janë rreth 224² sisteme të cilat nuk menaxhohen nga KRU, nga ky numer rreth 177, janë në gjendje funksionale përderisa 47 prej tyre , nuk janë funksionale dhe kanë nevojë për rehabilitim substancial. Në vitin 2011 vetem 24 sisteme rurale janë integruar në kaudër të KRU. Integrimi i këtyre sistemeve nuk është i lehtë dhe varet nga disa faktor siç janë; fillimisht vullneti i komunitetit për ti dorëzuar sistemin nën menaxhimin e KRU, sigurimi i fondeve shtesë për rehabilitimet e nevojshme për ti kthyer në gjendje funksionale si dhe gadishmeria e KRU për ti marrë nën menaxhim këto sisteme.

ZRRUM, është i interesuar që keto skema lokale të integrohen në kuader të Kompanive Rajonale në zonat respektive të shërbimit të tyre dhe i inkurajon KRU dhe popullatën, që të shprehin gadishmërin për integrimin e tyre. ZRRUM po ashtu është i sigurt se përfitimet janë të ndërsjellta për KRU rritja e bazës komerciale të tyre, përderisa benefitet për popullatën do të jenë; menaxhim me efektiv dhe profesional i këtyre skemave, rregullimit dhe mbikqyrjes nga ana e ZRRUM, si dhe përcjellja e kualitetit të Ujit në mënyrë të rregullt nga Institucioni përgjegjës.

Përcaktimi i tarifave

Gjatë vitit 2011, ZRRUM ka finalizuar tarifat për shërbime të ujit dhe të ujërave të zeza për një periudhë tre vjeçare (2012-2014), janë marrë parasyshë interesat e konsumatorëve me nevojën për të ruajtur integritetin financiar të KRU, aplikacionet tarifore të KRU, janë shqyrtuar në mënyrë të hollësishme, me qëllim që të sigurohemi që KRU të operojnë në mënyrën më eficiente të mundshme duke u kujdesur që konsumatorët nuk do paguajnë më shumë se që është e nevojshme. Po ashtu qasja jonë për përcaktimin e tarifave ka qenë që të sigurohemi që KRU të jenë në gjendje për të financuar aktivitetet e tyre në përputhje me standardet e përcaktuara të shërbimit.

Ne kemi qënë të kujdesshëm në qasjen tonë për të përcaktuar çaqe reale, sa i parket efiqencës së arkëtimit, megjithatë vlen të theksohet se shpenzimet operative kanë qënë të sfiduara në bazë të krahasimit të propozimeve (benchmarking). Por, ne kemi zgjedhur që të mos kundërshtojmë asnjë propozim në lidhje me shpenzimet për rritje infrastrukturore dhe për shpenzimet kapitale për asetet jo-infrastrukturore (si ato për mirëmbajtje kapitale poashtu edhe ato për rritje të infrastrukturës). Përqendrimi i sfidimit tonë është i drejtuar vetëm sa i përket përtëritjes infrastrukturore pasi që kjo fushë ka nevojat më të mëdha në lidhje me përmirësimet e niveleve të shërbimit dhe poashtu ka ndikim direkt dhe material në tarifa. Arsyeja jonë për rregullimin e programit të investimeve është e bazuar mbi sigurimin e një niveli minimal të përtëritjes infrastrukturore dhe janë bërë rregullime të mëtejshme për të siguruar një nivel minimal të rritjes reale të tarifave por dhe për të siguruar sinjale pozitive për investitorët. Edhe pse objektivat janë sfiduese ne besojmë se ato janë të arritshme, por për sukses të vërtetë KRU duhet të përpiqen për të përmbushur apo edhe tejkalojnë.

² Raporti mbi statusin e sistemeve të ujësjellësive rural që nuk oparohen nga KRU -KIWER

3 PERFORMANCA E KRU

Në këtë pjesë të raportit është pasqyruar performanca e KRU, përmes shumë treguesve të punës që i përfshijnë aspektet teknike, komerciale dhe financiare ndaras për shërbimin e furnizimit me ujë dhe shërbimin e ujërave të zeza, është dhënë po ashtu performanca financiare dhe komerciale për dy shërbimet në kuader të KRU. Në mënyrë specifike monitorimi i performancës është përqendruar në: (i) vlerësimin e performancës në raport me projektimet e bëra gjatë përcaktimit të tarifave, (ii) vlerësimin e performancës krahasuese në mes të kompanive, (iii) monitorimin e gjendjes financiare të KRU. Pjesa me e madhe e treguesve dhe të dhenave të rëndësishme statistikore veqmas për çdo KRU, janë paraqitur në SHTOJCA.

3.1 Furnizimi me ujë

Këtu është dhënë një përmbledhje e performancës së ofruesve të shërbimeve në furnizimin me ujë në vitin 2011 në raport me vitin 2010. Treguesit e theksuar të standardeve të shërbimit janë të bazuara në nivelet minimale të shërbimeve për të cilat çdo ofrues i shërbimit është pajtuar me rregullatorin për të ofruar. Përveç kësaj tregues të mëtejshëm financiar dhe komercial do të analizohen në raporte me caqet / pritjet që kanë qenë të përfshira në rishikimin tarifar 2009-2011.

3.1.1 Performanca teknike

Performanca teknike fokusohet mbi aspektet operative të furnizimit me theks të veçantë në standardet e shërbimit si dhe shërbyeshmerin e infrastrukturës, të cilat janë të ndërlidhura dhe ndikojnë në masën më të madhe me kënaqëshmërin e konsumatorëve me shërbimin e ofruar.

Standardet e shërbimit

Disa nga standardet me kryesore teknike për furnizim me ujë janë: kualiteti i ujit, presioni adekuat në rrjetin e ujësjellësit si dhe disponueshmeria e furnizimit me ujë.

Kualiteti i ujit

Obligim primar i çdo ofruesi të shërbimit duhet të jetë furnizimi me ujë të pijshëm me cilësi të lartë dhe në përputhje me standardet e aplikueshme në vend.




Figura A -1, Rezultatet e testimit të cilësisë së ujit

Figura A -1, e paraqitur më lartë ilustron rezultatet e testeve të cilësisë së ujit për vitet 2010 dhe 2011. Në bazë të rezultateve të analizave të raportuara dhe të dërguara nga IKSHPK i cili është përgjegjës institucional për monitorimin dhe testimin e kualitetit të ujit në bazë të Udhëzimit Administrativ 2/1999. ZRRUM, ka patur mundësi për të bërë vlerësimin e gjendjes së kualitetit të ujit të ofruar nga KRU, të cilat janë duke u rregulluar prej saj.

Uji i cili është ofruar për popullatën në zonën e shërbimit të KRU 'Hidrodrini', 'Hidroregjioni Jugor' dhe KRU 'Mitrovica' në vitin 2011, karakterizohet me një përqindje të lartë të dështimit të testeve si nga aspekti bakteriologjik ashtu edhe ai kimiko-fizik. Perderisa nga KRU 'Hidroregjioni Jugor' është shënuar përmirësim i kualitetit të ujit në vitin 2011, në raport me vitin 2010, tek KRU 'Hidrodrini' dhe KRU 'Mitrovica' përkundrazi është evident përkeqësimi i situates me kualitetin e ujit. Nga aspekti bakteriologjik (prezente janë bakteriet më të rrezikshme për shëndetin e njeriut Bakteriet Coliforme, Esheria Coli, etj). Sidomos brengosëse është situata në Komunën e Klinës, ku qytetarët e Klinës për një kohë të gjatë nuk janë furnizuar me ujë të përshtatshëm për tu konsumuar. Kjo gjendje vazhdon edhe me tej dhe aktualisht dështimi i kualitetit të ujit është në shkallë shumë të lartë nga aspekti kimik me prezencën e manganit (Mg) dhe të Nitriteve (NO₂), me vlera shumë të larta se sa ato të parapara me standardet vendore.

Problemin e kualitetit të ujit për qytetin e Klinës, ZRRUM dhe IKSHPK e kanë adresuar edhe tek Qeveria e Kosovës dhe Komuna e Klinës dhe me një bashkëpunim të ndërsjellët janë duke ndërmarrë veprime për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme për këtë çështje.

Nga të gjitha KRU, cilësin më të mirë të ujit për konsumatorët e tij e ofron KRU 'Radoniqi', me kalueshmeri të testeve prej afro 100%.

Padyshim se në përkeqësimin e kualitetin të ujit ndikim të madhë kanë edhe ndërprerjet e ujit, (mungese e furnizimit me ujë) por evidente është se faktor vendimtar janë; trajtimi jo efikas me preparatet kimike, aparatura dhe dozë jo-adekuate e preparatit.

Furnizimi me ujë jo cilësor ka impakt të drejtëpërdrejt në shëndetin e popullatës sidomos është i dëmshëm dhe i menjëhershëm dështimi i kualitetit të ujit nga aspekti bakteriologjik, pa e neglizhuar edhe dështimin e kualitetit të ujit nga aspekti fiziko- kimik, i cili nëse konsumohet në një periudhë më të gjatë, po ashtu shkakton dëme të mëdha në shëndetin e njeriut.

Presioni

Presioni i ujit në rrjetin e ujësjellësit po ashtu është një nga standardet e rëndësishme të shërbimit i cili duhet siguruar nga KRU, në bazë të rregulles për standardet e shërbimit janë dhënë vlerat referuese³ të cilat duhet të arrihen për presioni minimal dhe maksimal në pikën e kyqjes së shërbimit të konsumatorit. Ky tregues definon numrin e pronave që ndikohen rregullisht nga presioni i ultë duke përjashtuar rastet aksidentale të herë pas hershme të rënjes së presionit.

Presioni në rrjetë, është shumë vështirë të matet dhe të raportohet nga ofruesit e shërbimeve për shkakë të arsyeve të ndryshme teknike, p.sh. topografisë, formave të kërkesave dhe pengesave tjera teknike.

³ Presioni minimal 25 m. sh.u dhe presioni maximal 70 m.sh.u




Figura A-2, Presioni në rrjetin e ujësjellësit

Edhe në vitin 2011, nga KRU 'Bifurkacioni' dhe KRU 'Mitrovica' nuk janë raportuar të dhënat për presionet. Ndonëse të dhënat për presionet janë raportuar nga shumica e KRU, për keto të dhëna ende nuk mundemi të sigurohemi se janë me besueshmëri të plotë për shkakun se KRU, nuk bëjnë matje të rregullta si dhe ende nuk janë duke aplikuar programe të mirëfillta për menaxhimin e presioneve. Pavarësisht shqetësimeve të tilla, informacionet e pranuar sugjerojnë se ka probleme të vogla në lidhje me shtypjen e ujit, përveç KRU 'Hidroregjioni Jugor', shumica e KRU kanë raportuar shifër më të ulët se 5% të konsumatorëve që kanë shtypje të ulët të furnizimit me ujë.

Disponueshmëria

Një çështje me të cilën të gjithë Kosovarët janë më së të njohur është mungesa e furnizimit me ujë për 24 orë në ditë, madje edhe në qytetet e mëdha siç është vetë kryeqyteti i Kosovës, Prishtina.

Furnizimi me ujë është çështje e një interesi vital jo vetëm nga këndvështrimi i komoditetit për qytetarët por gjithashtu edhe për shëndetin publik.




Figura A-3, Besueshmëria e shërbimit (2011) e paraqitur si numri i konsumatorëve të ndikuar nga ndërprerjet e rregullta të furnizimit me ujë.

Ky tregues pasqyron numrin e pronave të prekura/ndikuara nga disponueshmëria, të ndara në tri kategori të pronave: (i) me 24 orë shërbim në ditë, (ii) me 18-23 orë shërbim në ditë dhe (iii) ato me më pak se 18 orë shërbim në ditë.

Situata e pasqyruar në figuren A-3, ka qenë larg asaj që mund të quhet ideale dhe në përgjithësi mundëti adresohen katër arsyeve; së pari, në disa KRU ekzistojnë ende kapacitete të limituara për trajtimin e ujit, së dyti rrjetet ekzistuese të ujësjellësit janë në gjendje të dobët, që rezultojnë në humbje të mëdha, së treti, rrjetet nuk kanë kapacitetin mjaftueshëm as edhe për pjesët të cilave u shërbejnë, dhe së katërti, kyçjet e paligjshme dhe ilegale të cilat janë burim keqpërdorimi enorm të ujit të pijshëm.

Asnjë përmirësim i rëndësishëm nuk është bërë në KRU 'Prishtina' dhe KRU 'Mitrovica'. Edhe për shkakun se me zhvillimin e zonave të reja të banimit, vendosja e shërbimit nuk është shoqëruar me një rritje proporcionale në kapacitetet e prodhimit. Ky fakt ka bërë situatën aktuale edhe më keq për konsumatorët egzistues.

Për KRU 'Hidrodrini', 'Hidromorava' si dhe KRU 'Radoniqi' problemet me furnizim, paraqiten kryesisht gjatë muajve të verës ku edhe keqpërdorimet e ujit të pijshëm nga qytetarët janë shumë të theksuara.

Megjithatë, ka pasur disa aktivitete të rëndësishme të cilat i ka ndërmarrë KRU 'Prishtina' gjatë vitit 2011 dhe janë në vazhdimësi në pjesë të ndryshme në sistemin e tubacioneve si dhe sigurimi i mjeteve financiare për ndërtimin e fabrikës së planifikuar prej kohësh e cila pritet të fillojë në vitin 2013, po ashtu edhe KRU 'Mitrovica' ka përfunduar fonde për ngritjen e kapaciteteve të fabrikës për trajtimin e ujit të pijshëm të cilat janë në vijim e sipër ku pritet të dyfishohen kapacitetet e saj të përpunimit. Këto aranzhime përfundimisht do të zgjidhin problemin kronik të kufizimit të ujit të furnizuar nga këto dy kompani.

Shërbyeshmëria infrastrukturore

Dy nga treguesit të cilët përcaktojnë shërbyeshmërinë infrastrukturore janë: plasaritja e gypave si dhe uji i pa-faturuar, dhe definohet si aftësia e aseteve për të ofruar nivelet e kërkuara të shërbimit.

Plasaritjet e gypave

Ky tregues paraqet numrin e plasjeve të gypave të ujësjellësit brenda një viti në raport me 100 km gjatësi të gypave të rrjetit.




Figura A-4, Plasjet e gypave të ujësjellësit

Në përgjithësi norma vjetore e deshtimit të gypave është e lartë në të gjitha KRU. Numrin me të paktë të plasjeve në gypa e ka raportuar KRU 'Prishtina' me 238.92 (plasje /100km), perderisa më së shumt ka raportuar KRU 'Hidromorava' me gjithësejt 714.58 (plasje /100km).

Në nivel të sektorit në vitin 2011, janë shënuar 6 herë më tepër plasje të gypave se sa në vitin 2010, kjo është jo vetëm se kemi një përkeqësim të performancës së rrjetit nga viti i kaluar, por kjo është para së gjithash për shkakun se këto të dhëna janë azhurnuar dhe raportuar me të sakta nga të gjitha kompanit.

Numri i lartë i plasjeve arsyetohet me faktin se KRU, në përgjithësi janë duke shpenzuar shumë pak në mirëmbajtjen kapitale të rrjetit të furnizimit me ujë.

Kjo performancë e ultë e sistemit të gypave të ujësjellësit deshmon se KRU, ballafaqohen edhe me nivel të lartë të humbjeve teknike të ujit.

Uji i pa-faturuar

Uji i pa-faturuar (UPF), paraqet diferencën në mes të vëllimit të ujit të prodhuar dhe ujit të shitur, në përgjithësi përbëhet nga humbjet komerciale (konsumi i pa autorizuar, pasaktësia e matjes) dhe humbjet teknike (rrjedhjet fizike në rrjetin e ujësjellësit, rezervuaret dhe lidhjet e shërbimeve deri në pikën e matjes së konsumatorëve), këto dy komponente të UPF mbulojnë tërë sistemin e furnizimit me ujë nga impianti i trajtimit të ujit e deri të ujëmatesi i konsumatorit. Menaxhimi i UPF është përgjegjësi eskluзивe e kompanisë që ofron shërbimin e ujësjellësit, përndryshe ky tregues është shumë domethënës në lidhje me rezultatin e punës së një kompanie duke ndikuar në menyrë esenciale në qëndrueshmërinë e saj financiare dhe operative.




Figura A – 5, Uji i pa-faturuar (sasi absolute)

Ngritjen më të lartë të UPF gjatë vitit 2011 në raport me 2010, me mbi 3.5 milion m³ kanë shënuar KRU 'Radoniqi' dhe KRU 'Hidroregjioni jugor'. Kjo ka ndikuar që krahas KRU 'Prishtina' dhe KRU 'Bifurkacioni' ndonse me një sasi më të vogël të rritjes së UPF, në vitin 2011 në raport me vitin 2010, që sektori në përgjithësi të vazhdoj trendin negativ përgjatë viteve në këtë tregues. Në vitin 2011 UPF, ka arritur nivelin rekord me rreth 90 milion m³ dhe është për 6.5 milion m³, më e lartë se sa që ishte në vitin 2010. Shifrat e tilla tepër të larta të UPF kanë ndikim shumë të madhë financiar sepse rritet kostoja e prodhimit të ujit duke qenë se prodhohet më shumë ujë se sa është e nevojshme pikërisht për ti mbuluar humbjet, ashtu siç ka ndodhur në vitin 2011 ku gjithë rritja e prodhimit të ujit ka shkruar si ujë i pa faturuar.




Figura A – 6, Performanca krahasuese për UPF, paraqitur si litra për konsumator për ditë (% e prodhimit)⁴

UPF i shprehur në litër për konsumator në ditë është njësi më e përshtatshme për krahasimin e performancës, prandaj është përdorur nga ne për të krahasuar performancën e KRU, ky tregues ka marrë gjithashtu parasysh efektet e furnizimit të kufizuar.

Për më tepër, ofruesit e shërbimeve nuk bëjnë ndarjen e UPF në humbje fizike dhe komerciale, ata kryesisht më tepër përqendrohen në zëvendësimin e tubacioneve të vjetra të shpërndarjes si zgjidhje për zvogëlimin e UPF se sa në adoptimin e një qasje më strategjike të problemit.

Figura A-6 tregon se KRU 'Hidrodrini' është shumë larg, me performancën më të dobët, me humbje të 1,635 litrave për konsumator në ditë në 2011, përderisa KRU 'Hidromorava' i ka performancën më të mirë me 650 litra për konsumatorë në ditë.

Katër, KRU nga gjithësejt shtatë duke përfshirë; Hidrodrinin, Mitrovicën, Prishtinën dhe Hidromoravën kanë shënuar trende pozitive.

UPF i shprehur në përqindje llogaritet si përqindje e sasisë së ujit të shitur në raport me sasinë e ujit të prodhuar, është përdorur sa për ilustrim edhe pse është një tregues i thjeshtë megjithatë ofron një pasqyrë të shpejtë të UPF. Vetëm KRU 'Radoniqi', 'Bifurkacioni' dhe KRU 'Hidroregjioni Jugor' kanë shënuar trende negative në vitin 2011, krahasuar me vitin 2010.

Rritja e UPF në KRU 'Radoniqi' si duket është cilësuar nga ofruesi i shërbimeve si shkak i paisjes së fabrikës së trajtimit të ujit me ujëmatës i cili është duke matur saktë sasinë e ujit të prodhuar përderisa në të kaluarën është mbivlerësuar sasia e ujit të prodhuar dhe kështu nuk është pasqyruar norma e vërtetë e UPF.

Vlenë të theksohet se vlera e lartë e humbjeve të pashmangshme ndryshon në varësi të sistemit, në përgjithësi ndërkombëtarisht pranohet një normë humbjesh në nivelin 15-20%, të ujit të prodhuar.

Pamvarsisht nga mbështetjet intensive për sektorin e ujit në Kosovë nga projektet e ndryshme, në këtë drejtim, KRU nuk ishin në gjendje për tu përballur me situatën alarmante me humbjet e ujit. Në këtë mënyrë UPF, jo vetëm se ka mbetur i lartë, ai edhe me tej është përkeqësuar. KRU duhet të bëjnë më shumë për të reduktuar UPF dhe në këtë mënyrë të rrisin të hyrat nga shitja e ujit dhe të orientojnë sasinë e ujit të për të plotësuar kërkesën në zonat që vuajnë nga furnizimi i kufizuar me ujë. Në këtë drejtim ZRRUM është duke ju ndihmuar KRU për zhvillimin e strategjive vetanake për uljen e UPF, përmes konsulencës së angazhuar për të zhvilluar një strategji të përgjithshme për reduktimin e UPF.

⁴ Vlera e UPF për kyçe në ditë është përshtatur/rregulluar që të kompensojë orët e shërbimit në ditë.

3.1.2 Performanca komerciale

Mbulueshmëria me shërbime

Mbulueshmëria me shërbime të furnizimit me ujë është e definuar si përqindja e popullsisë brenda zonës së shërbimit që kanë shërbim të furnizimit me ujë.




Figura A – 7, Mbulueshmëria me shërbime të furnizimit me ujë

KRU 'Radoniqi' ka shkallën më të lartë të shtrirjes së shërbimeve me 97% mbulueshmeri të furnizimit me ujësjellës përderisa KRU 'Hidromorava' dhe KRU 'Hidroregjioni Jugor' raportojnë mbulueshmeri më të ulët me përafërsisht 50% të zonave të tyre të shërbimit.

Ndërmarrjet publike të shërbimeve të ujësjellësit në Kosovë, funksionojnë në mënyrë krejtësisht tregtare dhe janë të vetë financueshme, në këtë kontekst performanca e mirë e shërbimeve për konsumatorin sidomos ato të cilat lidhen me mbulueshmërinë me shërbime, matja e konsumit të ujit si dhe shqyrtimi dhe zgjedhja e ankesave të konsumatorëve është esencial për performancën e tyre tregtare së këndejmi rritja e mbulueshmëris me shërbime duhet të jetë synim strategjik i tyre.

Matja e ujit

Matja e ujit të konsumuar është komponent kryesor për shfrytëzimin racional të saj nga ana e konsumatorëve.

Matja e ujit mundë të ndihmoj në uljen e konsumit të ujit duke ofruar informacione rreth sasisë së ujit të konsumuar, për më tepër faturimi përmes konsumit të matur jep një arsye që konsumatorët të përpiqen të ulin konsumin kjo veçanarisht është e dobishme në ato zona të cilat përballen me mungesën e ujit.




Figura A – 8, Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës

Figura A-8, tregon shkallën e konsumatorëve shtëpiak dhe të atyre jo-shtëpiak të cilet janë paisur me ujëmatës në raport me totalin e konsumatorëve të shërbyer.

Analiza e rezultateve tregon se mbulimi me ujëmatës në nivel të përgjithshëm është rritur nga 83% në 2010 në 84% në 2011. Paisja e konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës është në shkallën 84%, përderisa për konsumatorët, jo –shtëpiak është në nivelin 82% .

Matja e ujit të furnizuar në Kosovë nuk është konsistente. Shumë ndërtesa të vjetra kanë vetëm një ujëmatës kryesor që shërben për gjithë ndërtesën dhe fatura për ujë i ndahet proporcionalisht të gjithë konsumatorëve të asaj ndërtese në bazë të numrit të antarëve, përderisa ndërtesat tjera, në përgjithësi ato më të reja kanë ujëmatës për çdo apartament.

KRU ‘Hidromorava’ ende faturon vetëm rreth 55% të konsumatorëve shtëpiak bazuar në leximin e ujëmatësve. Përderisa KRU ‘Prishtina’ ka shkallën më të lartë të konsumatorëve të paisur me ujëmatës, ajo ka vazhduar me programin e instalimit të ujëmatësve dhe në vitin 2011, ka raportuar të ketë vendosur një numër të konsiderueshëm të ujëmatësve të rinjë.

KRU, janë të sfiduar nga ZRUM me një afat ligjor për të përmbushur standardin e shërbimit për të vendosur ujëmatës për të gjithë konsumatorët e tyre.

Ankesat

Ndërmarrjet Publike të ujësjellësit në Kosovë, kanë monopol në fushën e tyre të shërbimit dhe kjo është një arsye e cila mund të ndikojë që të mos kenë nevojë për dhënjën e shërbimeve të shkëlqyera për konsumatorin duke qenë të bindur se ata nuk kanë zgjedhje tjeter, megjithatë menaxhimi i mirë i ankesave nga KRU, duhet të shihet si një mundësi për përmirësimin afatgjatë të shërbimit dhe përmbushjen e pritjeve të konsumatorëve. Përditësimi, klasifikimi dhe analiza e të dhënave të ankesave të konsumatorëve janë elemente të rëndësishme të monitorimit dhe përmirësimit të performancës, ankesat ofrojnë informacione rreth pikave të dobëta në ofrimin e shërbimeve.




Figura A – 9, Ankesat për furnizim me ujë

Nga KRU në 2011, janë marrë në total 14,157 ankesa, që përfaqëson një rritje prej 13% nga 2010. KRU 'Prishtina', 'Hidrodriini' dhe KRU 'Hidromorava' kanë marrë numër më të madhë të ankesave, përderisa nga KRU 'Mitrovica', këtë vit kanë mundur të raportohen vetëm ankesat teknike, kjo për shkak të funksionimit të ultë të shërbimit të mardhënies me konsumator dhe të sistemit të dobët të menaxhimit të ankesave.

Rritja e konsiderueshme e ankesave komerciale në KRU 'Prishtina' është për shkakun e menyrës së faturimit, të konsumatorëve në banesat kolektive, kjo qështje është rregulluar dhe KRU 'Prishtina' dhe KRU e tjera, tani me kanë ka filluar zbatimin e mënyrës së faturimit në banesa kolektive sipas rregullimit të bërë nga ZRRUM.

Pjesa më e madhe e ankesave në vitin 2011, diku rreth 3/4, ashtu siç ishin edhe në vitin 2010, kanë të bëjnë me çështjet teknike vetëm 1/4 e ankesave kanë të bëjnë me çështjet komerciale që lë të kuptohet se egziston një pakënaqësi e përgjithshme me nivelin operativ të shërbimit, si pasojë e mosfurnizimi të rregullt, kualitetit jo të duhur të ujit dhe çështjeve të tjera operative.

Në përgjithësi KRU, janë duke zhvilluar dhe implementuar procedura mbi mënyrën se si ato duhet menagjuar ankesat e konsumatorëve.

3.1.3 Performanca Financiare

Në këtë pjesë të raportit janë analizuar aspektet financiare⁵ të furnizimit me ujë të tilla si: shitjet, kostot për njësi dhe shpenzimet.

Shitjet

Volumi i ujit të shitur

Volumi i ujit të shitur në raport me vlerësimet sipas Planit të Biznesit, është një tregues i performancës, dhe paraqet se sa ujë është shitur në raport me shitjet e planifikuara për të njëjten periudhë raportuese të përcaktuar në aplikacionet tarifore të KRU, gjatë procesit tarifar 2009-2011, Figura A – 10.

⁵ Të gjitha vlerat financiare të shprehura në euro janë rregulluar/përshtatur në bazë të çmimeve të mesit të vitit 2011 me qëllim të sigurimit të krahasimeve të duhura nga viti në vit




Figura A – 10, Shitjet e ujit në raport me shitjet e planifikuara gjatë rishikimit tarifor (2009-2011)

Në përgjithësi të gjitha KRU kanë shënuar përmirësim në këtë tregues në vitin 2011, në raport me vitin 2010, përveç KRU 'Hidromorava' e cila ka shënuar trend negativ në drejtim të rritjes së efikasitetit të shitjeve të ujit.

Ka dallime të mëdha në performancën e këtij treguesi në mes të KRU (Hidrodrini, Mitrovica, dhe Prishtina) të cilat kanë arritur të tejkalojnë planifikimet e shitjeve dhe KRU 'Hidromorava' e cila ka arritur cakun e planifikuar vetëm për 56%.

Duke patur parasysh se aplikacionet janë përgatitur në 2008, nuk është e vështirë për të kuptuar se mos arritja e shitjeve të planifikuara tek disa KRU për vitin 2011, janë si pasojë e mungesës së aftësive të mira planifikuese të shoqëruara me dështimet e rritjes së bazës së konsumatorëve sipas planifikimeve si dhe rritjes së UPF.

Ndikimi më i madhë janë të ardhurat e pamjaftueshme nga shitjet për të përmbushur nevojat financiare të KRU për financimin e mirëmbajtjes kapitale dhe rritjes infrastrukture.

Vlera e shitjeve (EUR)

Në Figura A-11, janë paraqitur vlerat totale të shitjeve të ujit në raport me vlerësimin e shitjeve sipas planit të bizneseve për periudhën raportuese.




Figura A – 11, Vlera e shitjeve të furnizimit me ujë në raport me shitjet e planifikuara të përcaktuara në rishikimin tarifar 2009-2011.

Në asnjë nga KRU vlera e shitjeve të furnizimit me ujë nuk është arritur në raport me planifikimet, në rastin më të mirë KRU 'Hidroregjioni Jugor' ka arritur nivelin prej 88% në vitin 2011, po aq sa ka qenë edhe në vitin 2010, përkundrazi KRU 'Mitrovica' ka arritur vetëm 55% të arrij cakun e synuar.

Kjo nënë performancë në vlerë të shitjeve i ka goditur plotësisht KRU sa i përket burimeve financiare që do të ishin të nevojshme për të përmbushur planet e tyre të investimeve. Kjo ishte e pritshme për shkakun e realizimit të dobët të parashikimeve të volumeve të shitjeve.




Figura A – 12, Vlera e shitjeve të furnizimit me ujë gjatë 2011 në raport me vitin 2010

Së bashku me dështimin për të përmbushur caqet e shitjeve, vlera absolute e shitjeve në 2011 në raport me 2010 është me e ultë për të gjitha KRU, përjashtuar vetëm KRU 'Hidroregjioni Jugor' ku shitjet ishin me të larta për rreth 10%.

Në nivel të sektorit të hyrat kanë qenë në terma real me të ulta për 0.7% në vitin 2011 në raport me 2010.

Kostot për njësi

Prodhimi

Kostoja e prodhimit për njësi është zvogluar tek të gjitha KRU duke përjashtuar vetem KRU 'Hidromoraven' për një margjinë relativisht të vogël. Në përgjithësi, kostoja mesatare e një njësie uji të prodhuar në 2011 ka shënuar rënje në 0.04 € për m³ nga 0.05 € sa ishte në vitin 2010.

Kostoja e prodhimit ndikohet në mënyrë të konsiderueshme nga lloji i sistemit të furnizimit, p.sh furnizimi me gravitet është më i lirë të operohet se sa sistemi me pompa po ashtu edhe burimi me cilësi të mirë të ujit të pa përpunuar zvogëlon dukshëm koston e prodhimit

Kostot e prodhimit të ujit sillet nga 0.03 €/m³ tek KRU 'Hidrodrini' në 0.07 €/m³ te KRU Hidroregjioni Jugor .

Kostoja totale për njësi për furnizimin me ujë

Paraqet koston totale (Operative +Mirëmbajtje kapitale të aktivitetit biznesor për furnizim me ujë në raport me volumin e ujit të shitur për të njëjtën periudhë raportuese.

Kostoja për njësi të furnizimit me ujë (Operative+Mirëmbajtje)




Figura A – 13, Kostoja për njësi të furnizimit me ujë (duke përjashtuar kthimin në Kapital dhe borxhet e këqija)

Nga figura 13, mund të vërehet se ekziston një amplitudë e gjerë sa i përket, koston totale për njësi për furnizimin me ujë, që nga Hidrodrini i cili ka nivel dukshëm më të ulët të koston se të gjitha kompanitë tjera të ujit me 0.19 €/m³ deri tek ajo më e lartë për KRU 'Prishtina' me 0,38 € për m³ të ujit të shitur dhe të paguar.

Niveli i lartë i humbjeve së bashku me efikasitetin e dobët në arkëtimin e të ardhurave kanë ndikim esencial në rritjen e koston së ujit prodhuar dhe të shitur.

Në përgjithësi, kostoja e një njësie të ujit të prodhuar dhe të shitur në 2011 krahasuar me 2010 ka qenë me e ultë për 0.01 €/m³.




Figura A – 14, Kostoja për njësi të furnizimit me ujë në raport me kostot e planifikuara për njësi

Kostot e planifikuara për njësi që rrjedhin nga rishikimi tarifar 2009-2011 (të rregulluara sipas niveleve të çmimeve në 2011, tek shumica e KRU ishin më të ulta se sa ato të planifikuara, përjashtuar KRU 'Prishtina', 'Bifurkacioni' dhe KRU 'Hidromorava', të cilat kanë arritur kostot e planifikuara për vitin 2011.

Gjatë procesit tarifar (2009-2011) KRU, kanë paraparë provizionime të konsiderueshme kapitale të cilat me siguri se do të rezultonin me përmirësimin e gjendjes së aseteve. Megjithatë shumica e KRU, nuk kanë arritur caqet për koston e planifikuar për shkakt të kufizimeve në të ardhura për të bërë shpenzimet e planifikuara në mirëmbajtje dhe përtrirje infrastrukturore të parapara. Kjo detyrimisht do të thotë se do të ketë përkeqësim të gjendjes së aseteve dhe ulje të nivelit të shërbimit.

Shpenzimet kapitale

Për vitin 2010 - 2011, KRU kanë paraparë provizionime të konsiderueshme rreth 64 milion Euro, për shpenzime kapitale, të parapara të sigurohen si nga mjetet vetanake ashtu edhe nga donacionet, 1/3 e këtyre investimeve janë paraparë të bëhen si mirëmbajtje kapitale përderisa 2/3 janë për rritje kapitale. Një pjesë e këtyre shpenzimeve, sidomos e atyre për mirëmbajtje kapitale, pritej se do të financohen nga burimet e veta financiare të KRU, dhe për këtë arsye janë përfshirë në tarifa gjatë procesi tarifar (2009–2011)




Figura A – 15, Shpenzimet kapitale për furnizim me ujë në raport me ato të planifikuara (sipas niveleve të çmimeve të mesit të vitit 2011)

Në përgjithësi nga të gjitha KRU gjatë këtyre dy viteve (2010-2011), janë realizuar vetëm 14% e investimeve nga shuma e planifikuar, pjesa më madhe e tyre janë shpenzuar në rritje të kapitalit, perderisa në vitin 2011, po ashtu janë shpenzuar një pjesë me vogël e tyre për mirëmbajtje kapitale.

Është e evidente se shumica e investimeve të realizuara janë nga donacionet zhvillimore siç është rasti me KRU 'Hidrodrini' dhe 'Hidroregjioni Jugor', ndersa më pak investime janë nga mjetet vetanake.

KRU 'Prishtina' për vitet 2010-2011, ka planifikuar investime të konsiderueshme në shërbimin e furnizimit me ujësjellës dhe atë kryesisht në rritje kapitale, është zhgënjyese se kjo kompani ka mundur të realizoj planifikimet gjatë kësaj periudhe për vetëm 4%, kryesisht nga mjetet vetanake.

Ndikimin kryesorë për mos përmbushjen e objektivave mund ti atribuohet, shkallës së arkëtimit dhe shitjeve më të ulëta në raport me ato të cilat janë planifikuar të realizohen, e që ka rezultuar me mungesën e mjeteve të nevojshme për investime.

Mos realizimi i investimeve të planifikuara në sasinë dhe dinamikën e parapar, sidomos ato të parapara në mirëmbajtjen kapitale kanë ndikuar në cilësinë e shërbimit si dhe rritjes së UPF.

3.2 Shërbimet për ujërat e zeza

Në këtë pjesë të raportit analizohet performanca e shtatë KRU, në lidhje me shërbimet për ujërat e zeza në vitin 2011. Analiza është fokusuar në krahasimin e performances së vitit 2011 në raport me vitin 2010, si dhe në nivelin e arritjeve të objektivave të përfshira në rishikimin tarifar (2009-2011), në aspektet operative, komerciale dhe atë financiare.

3.2.1 Performanca teknike

Në aspektin teknik të shërbimeve për ujërat e zeza, çështjet më të rëndësishme janë: cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara si dhe besueshmëria e nivelit të shërbimit.

Standardet e shërbimit

Cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara

Edhe në vitin 2011, ne nuk kemi pas mundësi të japim informacione për cilësinë e ujërave të zeza të shkarkuara, trajtimi i ujërave të zeza praktikisht në Kosovë ka filluar me marrjen në menaxhim nga KRU 'Mitrovica' të impiantit të parë të ndërtuar në komunën e Skenderajt, në shprehje se në vitin 2012, pasi të jenë raportuar të dhënat nga kjo kompani ne kemi mundësi të japim informacione për cilësinë e ujërave të zeza të shkarkuara nga ky impiant.

Është shumë brengosëse së tërë sasia e ujërave të grumbulluara nga sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza i menaxhuar nga KRU, pa kurrfar trajtimi paraprak hudhen në lumenj, kjo situatë ka pasur për pasojë kontaminim të plotë të tyre.

Besueshmëria dhe shërbyeshmëria

Besueshmëria e sistemit të shërbimeve të ujërave të zeza është matur në bazë të numrit të kolapseve për 100/km gjatësi të kanalizimit gjatë vitit.




Figura A – 16, Bllokimet e sistemit të kanalizimit

Nga figura A-16, mundë të shohim se disa KRU përfshir KRU 'Prishtina', 'Hidromorava' dhe KRU 'Bifurkacioni', të kenë raportuar numër shumë më të lartë të kolapseve në sistemin e kanalizimit, në raport me vitin 2010, përdallim nga KRU 'Radoniqi' dhe 'Mitrovica', të cilat nuk kanë raportuar të kenë pasur probleme me sistemin e kanalizimit.

Opinioni ynë është se ky numër me i lartë është për shkakun se disa KRU (Prishtina, Hidromorava dhe Bifurkacioni) kanë azhurnuar dhe raportuar këto informacione në menyrë më të rregullt.

Në përgjithësi norma mesatare e kolapseve për vitin 2011, është 387 kolapset/100km dhe është shumë me e lartë se norma e kolapseve në vitin 2010, kur ajo ishte 321 kolapset/100km në gypa të kanalizimit gjatë një viti.

Për një dështim të lartë të sistemit të kanalizimit si duket shkaktar është neglizhenca e vazhdueshme për ndërmarrjen e investimeve të domosdoshme për ta mbajtur në gjendje sa me funksionale këtë sistem.

Përderisa disa KRU (Bifurkacioni, Radoniqi, Prishtina), janë duke implementuar plane dinamike të pastrimit dhe mirëmbajtjes së kanalizimit në shumicën e KRU, qasja ndaj problemeve të paraqitura është ad-hok, pa ndonjë planifikim paraprak.

3.2.2 Performanca komerciale

Në këtë pjesë të raportit në fokusohemi në aspektet komerciale të ujërave të zeza siç është mbulueshmëria me shërbime dhe ankesat e konsumatorëve në lidhje me shërbimin e kanalizimit.

Mbulueshmëria me shërbime

Popullsia e furnizuar me shërbime të ujërave të zeza nga KRU, ndarë për popullsinë e regjistruar në zonën e shërbimit, shprehur si përqindje.




Figura A – 17, Mbulueshmëria me shërbimet e ujërave të zeza

Norma e shtrirjes së shërbimit me ujëra të zeza nga secila kompani është dhënë në figura A-17, nga i cili pasqyrohet se KRU 'Prishtina' ka nivelin më të lartë të shtrirjes me shërbime me 64%, ndërsa KRU 'Hidrodrini', ka nivelin më të ulët të shtrirjes me këtë shërbim me vetem 37%.

Në përgjithësi niveli i ultë në mbulueshmërin me shërbime të ujërave të zeza, paraqitet me faktin se aftësia e KRU-ve për të investuar dhe zgjeruar zonën e shërbimit është mjaft e kufizuar.

Përkundër shkallës së ulët të shtrirjes në 2011 krahasuar me 2010 numri i konsumatorëve të rinjë është rritur në nivel të sektorit për 3%.

Ne kemi mirë pritje që në aplikacionet për procesin tarifar (2012-2014) nga të gjitha KRU, janë përfshirë provizionime të rëndësishme për shpenzimet e rritjes së rrjetit të ujërave të zeza. Megjithatë ne e vlerësojmë, se përkunder vullnetit të KRU për të investuar në këtë shërbim ato janë të kufizuara sepse investimet e tilla janë të kushtueshme dhe niveli i investimeve të kërkuara nuk mund të ndërmerret pa mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar për zhvillim.

Ankesat

Në këtë vit KRU, kanë raportuar ndaras për ankesat e konsumatorëve për shërbimet e ujërave të zeza.

Në Figura A-18, më poshtë është paraqitur numri i ankesave të marra nga KRU, për vitin 2011, në lidhje me shërbimin e ujërave të zeza.

Ankesat për shërbimet e ujërave të zeza, 2011




Figura A – 18, Ankesat për shërbimet e ujërave të zeza

Ekziston një amplitudë e gjerë sa i përket numrit të ankesave në mes të katër kompanive të cilat kanë raportuar të dhëna, numrin më të madhë të ankesave ka pranuar KRU 'Prishtina', përderisa më pak ankesa për shërbimin e ujërave të zeza ka pranuar KRU 'Hidroregjioni Jugor'. Nga KRU 'Hidrodrini' dhe KRU 'Bifurkacioni' nuk është raportuar asnjë ankesë, jo për faktin se në keto dy kompani nuk ka probleme me shërbimet e ujërave të zeza, por ne konsiderojmë se në keto dy kompani ankesat e konsumatorëve nuk janë azhurnuar, në përputhje me kërkesat e ZRRUM.

Në përgjithësi në total nga të gjitha KRU, janë raportuar 4,051 sish, të gjitha ankesat kanë të bëjnë me aspektet teknike, sidomos me veshimet dhe kolapset e rrjetit të kanalizimit dhe asnjë ankesë nuk është bërë për çështjet komerciale.

Numri i ankesave për aspektet teknike na jep të kuptojmë se problemet në këtë shërbim janë enorme nga aspekti operativ, pak ankesa dhe atë vetëm tek KRU 'Hidroregjioni jugor', kanë të bëjnë me aspektet financiare.

ZRRUM, konsideron se ndryshimi i dukshëm prej vitit 2010, atëher kur nga kompanit nuk është marrë asnjë ankesë për aspektet e ujërave të zeza, mund të jetë rezultat i organizimit më të mirë të kompanive në regjistrimin dhe adresimin e ankesave dhe në ngritjen e vetëdijësimit të konsumatorëve lidhur me të drejtat e tyre. Për më tepër në një afat të shkurtër, ZRRUM do të shqyrtojë aranzhimet e çdo kompanie të ujit për regjistrimin dhe përgjigjen në ankesat e konsumatorëve.

3.2.3 Performanca Financiare

Kjo pjesë e raportit fokusohet në aspektet financiare⁶ të shërbimeve të kanalizimit të tilla si: shitjet, kostot për njësi dhe shpenzimet.

Shitjet

Ky tregues paraqet vlerën totale të faturimit(EUR), për shitjet e ujërave të zeza për të gjitha kategorit e konsumatorëve për periudhën raportuese në raport me vlerën e vlerësuar të shitjes për shërbimet e ujërave të zeza sipas planit të biznesit për të njëjten periudhë raportuese e shprehur si përqindje.

Vlera e shitjeve për shërbimet e ujërave të zeza drejtpërdrejt është e lidhur me volumet e shitjeve të ujit. Për shkak të nën-performancës së konsiderueshme të shitjeve aktuale të ujit krahasuar me shitjet e planifikuara vlera e shitjeve aktuale të shërbimeve të ujërave të zeza gjithashtu është nën vlerat e planifikuara të shitjeve.




Figura A – 19, Shitjet e shërbimeve të ujërave të zeza në raport me shitjet e planifikuara sipas rishikimit tarifar (2009-2011).

Asnjë nga KRU nuk kanë mundur të arrijnë objektivat e shitjeve të ujërave të zeza, gjatë këtyre dy viteve. KRU 'Hidroregjioni Jugor' dhe KRU 'Mitrovica', për dallim nga KRU e tjera, kanë shënuar trend pozitiv në vitin 2011 në raport me vitin 2010, në drejtim të arritjes së cakut edhe pse kanë qenë nën cakun e synuar.

KRU 'Bifurkacioni' është e fundit nga të gjitha kompanit e tjera duke arritur realizimin e planit të shitjeve të ujërave të zeza me vetëm 23%.

Të ardhurat nga shitjet e ujërave të zeza në vlerë monetare kanë qenë me të ulëta në vitin 2011 për 2.2%, se sa ato në vitin 2010. Perderisa KRU 'Mitrovica', KRU Hidroregjioni Jugor' dhe KRU 'Bifurkacioni', kanë shënuar trend pozitiv, katër KRU e tjera kanë pasur me pak të ardhura nga shitja e ujërave të zeza, sidomos kjo vlen për KRU 'Hidromorava' e cila ka realizuar të ardhura më pak për 23% nga shërbimet e ujërave të zeza, se sa në vitin 2010.

⁶ Sikurse për raportimin e performancës për furnizimin me ujë të gjitha vlerat e shprehura në euro janë të rregulluar sipas çmimeve bazë të mesit të vitit 2011 për të siguruar krahasime të duhura nga viti në vit.

Kostot për njësi

Kostot për njësi të shërbimeve të ujërave të zeza janë të definuara si kosto vjetore për konsumatorët shtëpiak të shërbyer.




Figura A – 20, Kostoja për njësi të shërbimeve të ujërave të zeza

Kostoja e shërbimit të ujërave të zeza është shumë e ultë për faktin se në Kosovë ende nuk është vendosur shërbimi i trajtimit të ujërave të zeza, keto ujëra grumbullohen përmes sistemit të kanalizimit dhe pa ndonjë trajtim paraprak hudhen në lumenj.

Kostot për njësi për vitin 2011, në raport me vitin dhe 2010, janë të përgjysmuara në KRU 'Prishtina', 'Hidroregjioni Jugor' si dhe KRU 'Bifurkacioni', për faktin se keto KRU me pak kanë raportuar të kenë bërë shpenzime operative në shërbimet e ujërave të zeza.

Shpenzimet kapitale për mirëmbajtje të shërbimeve të ujërave të zeza në vitin 2011, raportohet të kenë rritje shumë minore në raport me vitin 2010, duke mos e përjashtuar asnjë nga KRU.

Koston me të lartë e ka KRU 'Radoniqi' me 10.9 €/kons, përderisa koston më të ultë me vetem 2.9 €/kons në vit e ka KRU 'Prishtina'.

Në përgjithësi kompanitë nuk kanë të zhvilluar ndonjë program për pastrimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujërave të zeza, por aktivitetet e tyre në këtë shërbim janë sipas rastit dhe ad-hok, në përgjithësi sistemi i gypzimit të ujërave të zeza është në gjëndje të keqe, kjo deshmohet edhe me faktin se numri i ankesave për këtë shërbim është i lartë, por edhe kolapset e raportuara janë të larta të cilat po ashtu kanë shënuar rritje nga viti i kaluar.

Tani me ka indikacione se komuniteti i donatorëve janë duke orientuar donacionet e tyre në shërbimin e trajtimit të ujërave të zeza, përmes ndertimit të impiantëve të trajtimit të ujërave të zeza, kjo në masë të madhe do të shtojë koston e shërbimeve të ujërave të zeza dhe në terma afatgjatë mund të rezultojë që kostot e shërbimeve të ujërave të zeza do të rriten aq shumë sa që do të tejkalojnë kostot e shërbimeve të furnizimit me ujë.

Shpenzimet kapitale

Paraqesin totalin e shpenzimeve kapitale të bëra nga KRU, për mirëmbajtje dhe rritje kapitale në shërbimin e ujërave të zeza në raport me shpenzimet kapitale të parapara me planin e biznesit.




Figura A – 21, Shpenzimet aktuale/Shpenzimet e planifikuara (%)

Me procesin tarifor 2009 - 2011, sikurse të shërbimet e furnizimit me ujë, KRU kanë përfshirë provizionime të konsiderueshme rreth 37 milion Euro për mirëmbajtje kapitale dhe rritje kapitale në shërbimin e ujërave të zeza, por në realitet shpenzimet aktuale ishin shumë më të ulëta se niveli i pritur, ato ishin vetëm 1% e nivelit që ishte planifikuar gjatë procesit të rishikimit tarifor. Përpos KRU 'Hidromorava' dhe KRU 'Mitrovica' të cilat kanë realizuar investimet e planifikuara në nivelin 127%, përkatësisht 28%. KRU e tjera kanë pasur investime shumë minore, në shërbimin e ujërave të zeza për periudhën (2010-2011). Sidomos kjo është brengosëse për KRU 'Prishtina' e cila ka planifikuar shpenzime domethënëse kapitale në shërbimin e ujërave të zeza e të cilat nuk janë realizuar.

Ne kemi lejuar gjatë procesit tarifor 2012-2014 investimet të konsiderueshme në planet për të ardhmen të cilat do të sigurojnë investime adekuate në sektorin e ujërave të zeza për të siguruar nivele të kënaqshme të shërbimit, siç janë ato për përmirësim të mbulueshmërisë me shërbime dhe përtrirje infrastrukturore, ne presim që të njëjtat edhe të implementohen.

3.3 Performanca e përgjithshme Financiare KRU

Shitjet dhe arkëtimi i të ardhurave

Kërkesat nga KRU, për të ardhura paraqesin të ardhura e nevojshme në mënyrë që të paguajnë koston e udhëheqjes së biznesit të tyre dhe të financojnë investimet e tyre, komponentet kryesore të kërkesave për të ardhura janë shpenzimet operative, mirëmbajtja e kapitalit dhe kthimi në bazëne rregullatore të asetit.

Në përgjithësi ka pasur një përmirësim të lehtë në përmirësimin e eficiencës në arkëtim në 2011, në krahasim me 2010. Në nivele të sektorit norma e arkëtimit në raport me faturimin ka shënuar nivelin 69%, dhe është më e lartë për 3%.




Figura A – 22, Efiçenca në arkëtimin e të ardhurave

Është shqetësuese veçanërisht efiçenca e arkëtimin nga kategoria e konsumatorëve të amvisëris e cila në përgjithësi vazhdon të jetë e dobët. KRU ‘Radoniqi’ mbanë një rekord gjatë viteve të fundit, në këtë kategori.

Tabela A-1, Shkalla e arkëtimin, sipas kategorive të konsumatorëve dhe totali për vitet 2010-2011

Kategoria e Konsumatorëve	KRU Prishtina		KRU Hidroregjioni Jugor		KRU-Hidrodrini		KRU Mitrovica		KRU Radoniqi		KRU Bifurkacioni		KRU Hidromorava	
	2010	2011	2010	2011	2010	2011	2010	2011	2010	2011	2010	2011	2010	2011
Amvisëri	55%	58%	60%	62%	50%	56%	43%	42%	70%	75%	62%	64%	58%	72%
Komercial-Industrial	89%	87%	62%	76%	72%	66%	108%	69%	37%	47%	50%	50%	77%	85%
Institucione	97%	95%	92%	101%	78%	79%	74%	112%	90%	79%	85%	79%	92%	107%
Totali	70%	71%	69%	72%	59%	62%	54%	55%	67%	71%	61%	63%	66%	78%

Në vitin 2011, progresin me të mirë në efiçencën e arkëtimin e ka arritur KRU ‘Hidromorava’, si duket ka dhene rezultate ndihma e Komunes së Gjilanit për këtë kompani, po ashtu janë evidente disa nga masat e ndermarra nga kompanit në përpjekje për te rritur efiçencen e arkëtimin, në masë të madhe ka pasur aplikim të shkyqeve individuale të konsumatorëve, e cila është përdorur si masë operative për të nxitur konsumatorët të bëjnë pagesen për shërbimin e ofruar. ZRRUM përkrah politikat e shkyqjes dhe strategjitë e mbledhjes së borxhit të cilat duhet të zbatohen vazhdimisht. Megjithatë potencon faktin se është me rëndësi gjatë aplikimit të shkyqeve si kolektive ashtu edhe atyre individuale të respektohen procedurat të cilat dalin nga detyrimet ligjore.

Përformanca e shitjeve të KRU si për 2010, poashtu edhe për 2011 kanë qenë larg arritjes së cazeve të parapara. Tani më është me se e qartë se parashikimet e bëra ishin më se optimiste dhe se performanca aktuale ishte në nivelin e pritur kjo ka pasur ndikim të madhë në qarkullimin e paras së gatshme e që rrjedhimisht ka kufizuar seriozisht KRU, që të zbatojnë programet e tyre të planifikuara për investime.




Figura A – 23, Shitjet dhe arkëtimi i të ardhurave në raport me planifikimin (2011)

Figura A – 23, ilustron ndikimin e përgjithshëm të kombinuar për dështimin e arritjes së caqeve të shitjes dhe dështimin për të arritur caqet e arkëtimit, të dhënat janë dhënë vetëm për 2011.

Keshin e arkëtuar me të ultë prej (30%) në raport me shitjet e planifikuar e ka realizuar KRU 'Mitrovica', kurse atë më të lart prej (63%) e ka arritur KRU 'Hidroregjioni Jugor'.

Mesatarja e keshit të arkëtuar për shatë KRU, arrin vetëm 57% keshit të planifikuar për vitin 2011.

Përderisa mesatarja e keshit të arkëtuar për sektorin në tërësi, në raport me shitjet e planifikuara në vitin 2011, është vetëm 46%. Kjo është për 4%, më e ultë se sa në vitin 2010, ku keshi i arkëtuar ishte 50% në raport me shitjet e planifikuara.

Kthimi në kapital

Është i definuar si kthimi në bazën rregullatore të aseteve i paraqitur si të ardhura vjetore dhe rritje e kapitalit nga investimet e shprehura si përqindje e investimit origjinal.

Kthimi në kapital është i nevojshëm për të siguruar besimin e investorëve në sektorë, nese KRU duan që të tërheqin financime për përmirësimin e aseteve në mënyrë që të përmbushin përmirësimin e nevojshëm të nivelit të shërbimit.

Baza Rregullatore e Aseteve (BRA) mbi të cilën është përcaktuar kthimi në Kapital, është përcaktuar në vitin 2008 që nga procesit tarifar (2009-2011), ka filluar me 1 Janar 2009 me bazën rregullatore të aseteve (BRA) për secilën prej kompanive të ujit, duke përdorur vlerën e përcaktuar të aseteve prej €200 për konsumatorët e shërbimit të furnizimit me ujë dhe €100 për konsumatorët e ujërave të zeza.

Norma reale e kthimit në kapitale është e bazuar në praktikën e mira të vendeve të Evropës Perendimore, dhe tek ne për procesin tarifar 2009-2011, kemi llogaritur që kjo të jetë 4,0% si shumë e kalkuluar para normës së inflacionit.




Figura A – 24, Kthimi në bazën rregullatore të aseteve(BRA)

Vetëm tri KRU (Hidrodrini, Hidroregjioni Jugor dhe Bifurkacioni), kanë pasur kthime pozitive edhe pse jo në nivelin e planifikuar, kjo do të thotë se ato arritën të mbajnë shpenzimet e tyre, përfshirë zhvlerësimin sipas kostos aktuale dhe mirëmbajtjen infrastrukturore në BRA, brenda kufijve të të ardhurave të tyre, përkunder kësaj KRU e tjera kanë shenuar trende negative.

3.4 Performanca e përgjithshme e KRU

Arsyeshmëria

Është viti i dytë që ne po e masim performancën vjetore të KRU, sipas metodologjis se re të përvetsuar nga ZRRUM e cila është në perputhje me praktikat e mira ndërkombëtare që janë në zbatim nga rregullatoret e këtij sektori, ku në fokus janë kërkesat specifike rregullatore, në nivele të veçanta të shërbimeve dhe të implikimeve të kostos për konsumatorin. Ne përdorim pra, është vendosur koncepti i vlerësimit të performancës ndaj Kompanisë e cila ofron shërbime ideale në; Furnizimin me ujë dhe Shërbime të ujërave të zeza mbi bazën e cilësisë, niveleve të shërbimit, mbulueshmërisë si dhe Efiçencës komerciale dhe financiare.

Vlerësimi i performancës

Shërbimet e furnizimit me ujë

Në figuren A-25, është paraqitur performanca e përgjithshme e furnizimit me ujë për shtatë KRU, performanca është matur në pesë fushat përfshirë: (i) Cilësin e ujit, (ii) Presionin, (iii) Disponueshmerin me ujë, (iv) Mbulueshmerin me shërbime, dhe (v) Efiçenca e kostos. Vlerësimi i performancës bazohet në performancë krahasuese me nivelin ideal të performancës së pritëshme të kompanisë që funksionon mirë dhe ofron furnizim efiçent me ujë.




Figura A – 25, Vlerësimi i përgjithshëm i performancës për furnizimin me ujë (2010 & 2011)

Kompania me performancën më të mirë në furnizimin me ujësjellës është KRU ‘Hidrodrini’, performanca e saj është afër performancës Ideale të furnizimit me ujë duke arritur nivelin 96% prej atij maksimal prej 100%. Megjithatë kualiteti i ujit si dhe mbulueshmeria me shërbime janë fushat të cilat kjo kompani ka vendë të përmirsohet edhe me tej.

Probleme të theksuara janë evidente në kufizimet e furnizimit me ujë tek të gjitha KRU më përjashtim të KRU ‘Hidrodrinit’, sidomos këto janë shqetësuese në zonën e shërbimit të KRU ‘Prishtina’ dhe KRU ‘Mitrovica’. Ne presim që në këto dy kompani për një kohë të afërt do të ketë përmirësime të ndjeshme pasi këto kompani kanë bërë aranzhime konkrete për të zgjidhur këtë problem.

Përmirësimet në mbulueshmërin me shërbime të ujësjellësit gjatë këtyre viteve ka qenë relativisht e ngadalshme, KRU ‘Hidroregjioni Jugor’ dhe KRU ‘Hidromorava’ ende kanë për të bërë shumë në këtë drejtim pasi ato janë duke ofruar shërbimet e tyre vetëm për gjysmën e popullatës në zonat e tyre të shërbimit. KRU ‘Radoniqi’ po thuhet se ka arritur shkallën e plotë të mbulueshmerisë me shërbime të ujësjellësit në zonën e saj të shërbimit.

Vetëm tri KRU, (Hidroregjioni Jugor, Bifurkacioni dhe Hidrodrini) në vitin 2011 në raport me vitin 2010, kanë shënuar progres në shërbimin e furnizimit me ujë.

Në përgjithësi niveli i shërbimit të furnizimit me ujë në 2011, në raport me performancën ideale është në nivelin 76% dhe është me e përmisuar për 3% në krahasim me vitin 2010. Përmirësime në 2011 në raport me vitin 2010, janë identifikuar tek standardet e shërbimit, Presioni, Disponueshmeria me ujë si dhe të Mbulueshmëria me shërbimet me ujësjellës. Kualiteti i ujit po thuhet se është i njëjtë me vitin e kaluar përderisa performancë negative është shënuar tek efienca e kostos.

Shërbimet për ujërat e zeza

Performanca e KRU, në lidhje me shërbimet e ujërave të zeza është bërë në aspektet si: (i) Cilësia e ujërave të zeza të shkarkuara, (ii) Besueshmëria e shërbimit, (iii) Shtrirja me shërbime, (iv) dhe Efiençën e kostos.




Figura A – 26, Performanca e përgjithshme e shërbimeve të ujërave të zeza (2010 & 2011)

Meqenëse në Kosovë, ende nuk ka shërbime të trajtimit të ujërave të zeza, performanca e KRU është vlerësuar vetëm në dy tregues atë të Shtrirjes me shërbime të kanalizimit si dhe për Efiçencën e kostos.

Përderisa performanca e KRU, në lidhje me efiçencën e kostos është e plotë, ajo në mbulueshmerinë me shërbime të kanalizimit ende lenë vend për tu përmirësuar, në rastin më të mirë është performanca e KRU 'Prishtinës' me vetëm 64% të mbulueshmëris me këtë shërbim, perderisa KRU 'Hidrodrini' ka mbulueshmëri tepër të ultë me vetëm 36% të shtrirjes në zonën e saj të shërbimit. Performanca e KRU 'Prishtina' si kompania me performancën më të mirë tek shërbimi i ujërave të zeza në raport me performancën ideale është në nivelin 43%.

Në nivel të sektorit performanca e përgjithshme e KRU në këtë sektorë për 2011 është 34%, në krahasim me performancën e kompanis së synuar, duke mos shënuar ndryshim nga viti 2010. Kjo gjendje me nivelin e shërbimit të ujërave të zeza le të kuptoj se ky sektor në të ardhmen ka nevojë të mëdha për investime po thuajse në të gjitha fushat, që nga zhvillimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza dhe objekteve përcjellëse e deri te zgjerimi i rrjeteve të kanalizimit.

Performanca e përgjithshme e kombinuar

Në vazhdim është dhënë performanca e përgjithshme e KRU për të dy shërbimet atë të furnizimit me ujë dhe shërbimeve të ujërave të zeza, duke e kombinuar me performancën financiare (Profitabilitetin dhe Efiçencën komerciale).

Performanca mesatare e sektorit në vitin 2011, për të dy shërbimet (Furnizim me ujë dhe shërbime të ujërave të zeza), ka arritur shumë pak progres megjithat ende është nën nivelin e 50%, të performancës ideale. Aryseja kryesore për gjendjen aktuale të performancës së përgjithshme nuk është vetëm performanca e shërbimeve të ujërave të zeza, (mbulueshmëria e ultë me shërbime si dhe mungesa e trajtimit të ujërave të zeza), por edhe performanca ende e ultë e efiçences komerciale.




Figura A – 27, Performanca e përgjithshme e KRU (2010 & 2011)

Fushat në të cilat janë shënuar progresë është ai në furnizimin me ujë dhe në eficienten komerciale, të gjitha KRU pa përjashtim kanë shënuar trend pozitivë, është për tu vlerësuar në këtë aspekt KRU 'Hidromorava', e cila ka shënuar një performancë më të theksuar në këtë aspekt. Performanca e shërbimeve të ujërave të zeza është në nivel shumë të ultë pa asnjë përmirësim gjatë kësaj periudhe analizuese (2010-2011).

Profitabiliteti është një fushë ku performanca e të gjitha KRU është dukshëm me ultë në vitin 2011, se sa gjatë vitit 2010. Vetëm tri KRU (Hidroregjioni jugor, Hidrodrini dhe Bifurkacioni), në vitin 2011 kanë arritur të jenë pak profitabile që d.th, se me qarkullimin financiar të tyre kanë arritur të mbulojnë shpenzimet operative dhe mirëmbajtjen e kapitalit duke përjashtuar edhe provizionimin e borxheve të këqija.

KRU 'Radoniqi' ka siguruar një performancë më të mirë nga të gjitha KRU e tjera, megjithatë niveli i saj i performancës me 56% ndaj performancës ideale është shumë i ultë.

Tani është mëse e qartë se parashikimet e bëra në procesin rishikues tarifar (2009-2011), ishin mëse optimiste dhe se performanca aktuale ishte nën nivelin e pritur. Kjo kishte ndikime të mëdha në qarkullimin e parasë së gatshme e që rrjedhimisht ka kufizuar seriozisht KRU që të zbatojnë programet e tyre të planifikuara për investime.

Ne poashtu jemi te bindur se për shumicën nga përmirësimet e nevojshme, kërkohen nivele të konsiderueshme të investimeve. Megjithatë për të siguruar investime të tilla, KRU duhet të demonstrojnë aftësitë e tyre për të maksimizuar eficienten në ato zona që ato janë nën kontroll të drejtpërdrejtë të tyre, në veçanti në eficienten e arkëtimit të ardhurave dhe eficienten operative.

ZRRUM ka një rolë të madh në sigurimin që tarifat e përcaktuara të jenë të mjaftueshme për të financuar planet e investimeve të nevojshme për KRU për të arritur nivelin e tyre të objektivave të shërbimit dhe për të siguruar që KRU në të vërtetë ndërmarrin aktivitetet e investimeve të lejuara gjatë rishikimit të tarifave.

Duke mos dëshiruar që kjo situatë të përsëritet në periudhën e ardhshme 3 vjeçare, përmes procesit tarifar (2012-2014). Kemi parapar tarifa të balancuara duke marrë parasysh përballueshmërinë e pagesës se konsumatorëve në Kosovë. Ne kemi sfiduar shumë pakë investimet kapitale por gjithëashtu kemi qenë të kujdesshëm në qasjen tonë për të përcaktuar cace reale, por megjithatë sfiduese.

4 PERFORMANCA E SEKTORIT

Kjo pjesë e raportit paraqet një pasqyrë të shkurtër të performancës së sektorit në disa prej treguesve të rëndësishëm siç është prodhim i ujit të pijshëm, shitja, mbulueshmëria, qarkullimi, investimet kapitale për periudhën (2006-2011).

Më herët në këtë raport kemi shqyrtuar dhe analizuar secilin tregues veçmas duke dhënë informacione për nivelin e tyre për çdo KRU, dhe tani do të japim një pasqyrë gjithëpërfshirëse të performancës së përbashkët për të gjitha KRU, të cilat reflektojnë në performancën e sektorit.

4.1 Uji i prodhuar, shitjet dhe UPF

Figura A – 28, paraqet ujin e prodhuar dhe të shitur gjatë gjashtë viteve të fundit, diferenca është e definuar si ujë i pa-faturuar.




Figura A – 28, Prodhimi i ujit, shitjet dhe uji i pa-faturuar

Prodhimi i ujit gjatë viteve natyrshëm ka pasur trende të rritjes duke pasur parasysh nevojat gjithnjë në rritje të popullatës për këtë produkt jetik, një rënje e theksuar ka ndodhur gjatë viteve 2007-2008, kur për shkakë të thatësis e cila ka mbretëruar në vendin tonë, disa KRU është dashur të menaxhojnë në mënyrë të kujdesshme me sasin e disponuar të ujit në burime dhe për këtë shkakë kanë ulur sasin e prodhuar për të siguruar vazhdimësin e furnizimit me ujë për një periudhe sa më të gjatë. Në vitin 2011, nga shtatë KRU janë prodhur dhe distribuar tek konsumatorët mbi 146 milion m³ ujë të pijshëm.

Shitja e ujit gjatë kësaj periudhe 6 vjeqare ka mbetur në nivel konstant mesatarisht rreth 56 milion m³ uji i faturuar te konsumatorët për çdo vit.

Pamvarsisht planifikimeve të KRU, për të shitur sasi më të mëdha të ujit, edhe për kunder se gjatë kësaj periudhe ka pasur ngritje të bazes së konsumatorëve planet nuk kanë mundur të arrihen, kjo ka rezultuar që UPF nga KRU, të jetë shumë i lartë dhe vitë pas viti të ketë vlera maksimale në raport me vitin paraprak. Në këtë vit UPF ka arritur nivelin rreth 90 milion m³, kjo është shumë brengosëse për faktin se KRU duhet të prodhojnë 3m³ për të mundur të shesin 1m³, kur kësaj i shtohet edhe shkalla e ultë e arkëtimit të realizuar, KRU sillen në një gjëndje të pa qëndrueshme financiare, dhe të pa fuqishme për të ndërmarre ndonjë investim kapital të rëndësishëm.

Investimet në infrastruktur për të ulur UPF e cila aktualisht është duke shkaktuar një humbje të madhe të të ardhurave potenciale për ofruesit, shpresohet që kjo situatë do të përmirësohet në të ardhmën e afërt. Menaxhimi dhe qeverisja e mirë korporative shoqëruar me investimet të konsiderueshme në sektor është një parakusht që ofruesit e shërbimeve të përmirësojnë pozitën e tyre të qëndrueshme.

Ne jemi të bindur se mbi 50% e UPF është humbje komerciale e cila shkaktohet nga keqperdorimet e ujit prej qytetarëve përmes lidhjeve ilegale por edhe hargjimeve enorme nga konsumatorët të cilët faturohen në mënyrë paushalle.

Ne i inkurajojmë KRU që të bëjnë shumë më tepër se sa ato janë duke bërë për momentin sa i përket reduktimit të UPF dhe në këtë mënyrë të rrisin të ardhurat e tyre si dhe të sigurojnë sasi më të madhe të ujit për ato zona që vuajnë nga kufizimet e ujit.

4.2 Mbulueshmëria me shërbime

Trendet e rritjes së mbulueshmërisë për të dy aktivitetet biznesore janë të ilustruara në Figura A – 29 më poshtë.




Figura A – 29, Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit dhe të kanalizimit

Në përgjithësi shtrirja e shërbimeve me ujësjellës është në nivelin 74% dhe në raport me vitin 2010 ka shënuar progress për 4%, perderisa niveli i shërbimit me kanalizim është vetëm 51%.

Ne i kemi marrë parasyshë projeksionet e KRU me procesin e zhvilluar tarifor (2012-2014), që të përshpejtojnë planet e tyre për zgjerimin e zonës së mbulueshmërisë me shërbime duke e parë këtë jo vetëm si interes për konsumatorët por si të dobishme edhe për vetë KRU e kjo si rezultat i të hyrave shtesë që mund të sjellin konsumatorët e rinj. Ne sigurisht presim që të përfshijnë investimet në zgjerimin e mbulueshmërisë me shërbime me qëllim të përmbushjes së objektivave afatgjata të mbulueshmërisë së plotë me shërbime, vetëm zgjerimi i rrjeteve nuk është i mjaftueshëm. Në këtë raport tashmë është treguar mungesa e kapaciteteve prodhuese që rezultojnë në furnizim aktual jo të vazhdueshëm, kështu që çdo zgjerim i rrjetit për konsumatorët e rinj duhet të shoqërohet me investime plotësuese në resurset dhe objektet prodhuese të ujit në zgjerimin e rrjeteve të ujërave të zeza dhe zhvillimin e impianteve modernë për trajtimin e ujërave të zeza si dhe objekteve për shkarkimin e llumit.

Në bazë të analizës së trendeve nga e kaluara dhe normave të parashikuara të rritjes së numrit të konsumatorëve, mbulueshmëria e plotë me shërbime të ujësjellësit pritet të arrihet rreth vitit 2020, për sa i përket ujërave të zeza mbulueshmëria e plotë duket se do të vonohet edhe me tej duke marrë për bazë se investimet në këtë shërbim janë dukshëm më të ulta se sa në shërbimin e ujësjellësit.

4.3 Të ardhurat e planifikuara, qarkullimi dhe paraja e gatshme e arkëtuar

Performanca e shitjeve të sektorit (rregulluar për nivelet e çmimeve të mesit të vitit 2011) është paraqitur në Figura A – 30

Qarkullimi i planifikuar, Qarkullimi aktual dhe arkëtimi i planifikuar dhe aktual (sipas nivelit të çmimeve të mesit 2011)




Figura A – 30, Performanca financiare e sektorit (nivelet e çmimeve të mesit të vitit 2011)

Figura A - 20, tregon efikasitetin mesatar të qarkullimit dhe inkasimit gjatë 6 viteve, dhe jepë një pasqyrë me të çartë të qarkullimit dhe arkëtimit gjatë viteve duke eliminuar shtrembërime që mund të ndodhin gjatë një viti financiar.

Planifikimet në përgjithësi të KRU, në lidhje me qarkullimin dhe arkëtimin gjatë procesit tarifor (2009-2011), kanë qenë mjaft ambicioze për tu arritur, përderisa te arkëtimi i keshit ka shënuar trende graduale në rritje por të qëndrueshme, qarkullimi aktual ka qenë i paqëndrueshëm gjatë viteve edhe përkunder asaj se gjatë procesit tarifor (2009 -2011) ka pasur ngritje të tarifave, tani në vitin 2011 qarkullimi aktual ka qenë më i ultë se sa në vitin 2010, duke u kthyer përafërsisht në qarkullim e ndodhur në vitin 2006. Kjo arsyetohet edhe me faktin se edhe shitjet vëllimore të ujit kanë mbetur konstante ashtu siç edhe mundë të shihen në Figuren A-28.

ZRRUM mendon se caqet e vendosura nga ofruesit e shërbimeve e të miratuara nga rregullatori për procesin tarifor (2012-2014), janë më reale, sfiduese dhe shpresëdhënëse për tu përmbushur. Me përmirësimin e shkallës së arkëtimit sipas projeksioneve të planifikuara të kompanive do të krijohen mundësi më të mira për vetëqëndrueshmeri financiare të tyre dhe krijim të kushteve për investime më të mëdha nga burimet vetanake dhe me këtë edhe në ngritjen e nivelit të shërbimeve për konsumatorët e shërbyer.

4.4 Shpenzimet kapitale (mirëmbajtja dhe rritja kapitale)

Nga të gjitha KRU është pritur që të realizojn investime të konsiderueshme në shërbimin e furnizimit me ujë dhe në shërbimin e ujërave të zeza. Nga totali i shumës së planifikuar për periudhën (2010-2011), prej afro 102 milion Euro, me një ndarje prej përafërsisht me 2/3 në furnizim me ujë dhe 1/3 në shërbimin e ujërave të zeza, janë realizuar, vetëm 8,914,718 milion Euro në ujë dhe 344,665 Euro në ujëra të zeza. Në përgjithësi për të dy shërbimet janë realizuar vetëm 9% e planifikimeve gjatë procesit tarifor (2010-2011).

Shumica e Investimeve kapitale që janë realizuar në këto dy vite ashtu siç edhe ka ndodhur edhe gjatë viteve të kaluara, kryesisht janë financuar nga donatorët e ndryshëm të cilët e kanë mbështetur rikonstruimin dhe zhvillimin e këtij sektori.

Planifikimet për shpenzime në investime kapitale për këtë periudhë dy vjeqare (2010 - 2011) nga mjetet vetanake të KRU për të dy shërbimet, (furnizim me ujë dhe shërbimit të ujërave të zeza) në total kanë qenë 15,912,700 €, përderisa realizimi i tyre ka arritur vlerën prej 2,208,496 €.

Mos realizimi i investimeve sipas lartësisë dhe dinamikes së planifikuar, qoftë nga mjetet vetanake qoftë me mjetet financiare nga donatorët ka sjellë rrezikun që baza e aseteve të tanishme të dobësohet duke shkaktuar rrezikun e vazhdueshmërisë së ekzistimit dhe të shërbyeshmërisë së tyre.

Me rishikimin tarifor (2012 - 2014), janë parapar provizionime të mjaftueshme për mirëmbajtje efektive kapitale dhe rritje kapitale. Prandaj ne kërkojmë nga KRU të sigurojnë që investimet e planifikuara e të aprovuara nga ZRRUM të zbatohen plotësisht.

5 PERFORMANCA E FURNIZUESIT TE UJIT ME SHUMICË (NH IBER-LEPENCI)

Përgjegjësia e ZRRUM, përfshihet edhe në Rregullimin e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit me shumicë. Aktualisht NH Ibër-Lepenci si ofrues i këtij lloji shërbimi që ofron furnizim të ujit me shumicë për KRU 'Mitrovica' dhe KRU 'Prishtina' është liçencuar nga ZRRUM. Prandaj, NH 'Iber-Lepenci' i nënshtrohet rregullimit ekonomik vetëm në këtë pjesë të biznesit të saj.

Tabela A - 2 Të dhënat statistikore për NH 'Ibër-Lepenci'

Të dhënat statistikore për 2010 /2011	2010	2011
Vëllimi ujit me shumicë të faturuar (m3)	17,817,840	17,817,840
Faturimi për ujin me shumicë (€)	374,962	323,244
Arkëtimi për ujin me shumicë (€)	120,990	697,143
Kostoja e operimit për furnizimin e ujit me shumicë (€)	484,965	339,413
Numri i punëtorëve të angazhuar në furnizimin e ujit me shumicë	21	25

Meqenëse natyra e shërbimeve të ujit me shumicë është më ndryshe nga aktivitetet e furnizimit me ujë të pijshëm mundësia e vlerësimit të performancës është e kufizuar vetëm në disa tregues financiar.

Në tabelen A-3, është dhënë një pasqyrë të treguesve financiar në bazë të cilëve mundë të vlerësohet performanca e NH 'Iber-lepenci'.

Tabela A – 3, Performanca e NH 'Ibër-Lepenci'

Treguesi i performancës	2010	2011	Trendi
Shkalla e arkëtimit	32%	215%	Pozitiv
Norma e punës	0.77	0.95	Pozitiv
Norma e mbulimit të punës	0.25	2.05	Pozitiv
Kostoja e operimit për njësi (€/m3)	0.027	0.019	Pozitiv

Sasia e ujit të furnizuar edhe në vitin 2011, për dy ujësjellësat rajonal ka qenë e njëjtë me vitin 2010.

Të gjithë treguesit financiar të kësaj kompanie kanë shënuar progres në vitin 2011 në raport me vitin paraprak.

Shkalla e arkëtimit në vitin 2011 është rritur në nivelin 215%, kjo është ardhur si rezultat i arkëtimit të borxheve nga KRU 'Mitrovica'. Në faktë KRU 'Mitrovica' gjatë viteve ka akumuluar një borgjë të lartë për këtë ndërmarrje e cila ka arritur ti shlyej këtë vitë në tërësi.

6 AKTIVITETET E KKK

Një ndër funksionet dhe përgjegjësitë më të rëndësishme të ZRRUM është edhe mbrojtja e qëndrueshme e interesave të konsumatorëve duke u përkujdesur, që shërbimet që atyre iu ofrohen nga Kompanitë e licencuara janë në nivelin e standardeve të përcaktuara, dhe se ata të kenë në dispozicion mekanizma efektiv për adresimin e ankesave dhe pakënaqësive të tyre. Me qëllim të realizimit të këtyre interesave, konform Ligjit për Ofruesit e Shërbimeve të Ujësjetillës, Ujërave të Zeza dhe të Mbeturinave në Kosovë, Nr.03/L-086 dhe të Rregulles për Komisionin Këshillues të Konsumatorëve për Shërbimet e Ujit dhe Mbeturinave në Kosovë (R-08/U&M). Kjo Rregullë e amandamentuar në muajin Prill 2011, ka parapar disa ndryshime të rëndësishme me qëllim që këto KKK, të jenë më funksionale dhe efektive. Andaj në harmoni me këto dispozita, ZRRUM në Qershor 2011 pas shqyrtimit të propozimeve nga Kuvendet Komunale, intervistave dhe konsultimeve të bëra ka bërë rizgjedhjen e anëtarëve të rinjë të Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve në 7 Regjione të Kosovës.

Secila komunë brenda Regjionit të përcaktuar, ka 1 (një) përfaqësues respektiv në KKK i cili përfaqëson interesat e konsumatorëve të sektorit të shërbimeve të ujësjetillës dhe të mbeturinave.

Roli dhe përgjegjësitë e KKK konsistojnë në:

- Zgjidhjen e ankesave të parashtruara nga konsumatorët të cilat nuk janë trajtuar dhe zgjidhur nga kompanitë në mënyrë të drejtë për konsumatorin.
- Ndërmarrjen e sondazheve, studimeve dhe anketimeve lidhur me standardet e shërbimeve, me kërkesë të Rregullatorit.
- Ofrimin e këshillave për Rregullatorin lidhur me tarifat e shërbimeve.

Tabela A-4 Numri i ankesave të parashtruara KKK

REGJIONI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsejt
KKK Prishtinë	4	5	3	3	1	9	1	5	2	3	1	1	38
KKK Mitrovicë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2	-	-	2
KKK Pejë	-	-	-	-	-	-	-	1	-	-	-	-	1
